

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për
Ndjekjen Penale të Personave
Përgjegjës për Shkelje të Rënda të
Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare
Të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që
prej vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4-A

Data: 23 korrik 2009

Original: Anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para:

**Kryegjykatësit Liu Daqun
Gjykatësit Iain Bonomy
Gjykatësit Mehmet Güney
Gjykatësit Fausto Pocar
Gjykatësit Andrésia Vaz**

Sekretari:

Z. John Hocking

Aktgjykim i datës:

23 korrik 2009

PROKURORI

k.

ASTRIT HARAQISË

dhe

BAJRUSH MORINËS

Publik

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit:

Zj. Barbara Goy

Avokatit të Astrit Haraqisë:

Z. Karim A. A. Khan

Avokatit të Bajrush Morinës:

Z. Jens Dieckmann

PASQYRA E LËNDËS

I. HYRJE	1
A. RRETHANA	1
1. Bajrush Morina	1
2. Astrit Haraqija.....	2
B. APELET.....	3
C. LIRIMI I PËRKOSSHËM I KUSHTËZUAR.....	4
D. KËRKESË PËR ARGUMENT GOJOR.....	5
II. STANDARDET E SHQYRTIMIT	5
III. PIKAT E PËRBASHKËTA TË APELIT	6
A. PRETENDIM PËR GABIM NË PRANIMIN E PËRGJIMEVE SI PROVA (MORINA PIKAT 1A DHE 2; HARAQIJA PIKA 4).....	6
B. PRETENDIM PËR GABIM NË PRANIMIN E INTERVISTËS SË TË DYSHUARIT (MORINA PIKA 3; HARAQIJA PIKA 3).....	11
IV. APELI I BAJRUSH MORINËS.....	14
A. PRETENDIM PËR GABIME NËPËRMJET KEQINTERPRETIMIT TË PROVAVE TË PËRGJIMEVE (MORINA PIKA 1B).....	14
B. PRETENDIM PËR GABIME NË KONKLuzionIN SE MORINA KREU SHPËRFILLJE (MORINA, PIKAT 4-7)	17
V. APELI I ASTRIT HARAQISË.....	19
A. PRETENDIM PËR GABIME LIGJORE DHE FAKTUALE NË KONKLuzionET E DHOMËS GJYQËSORE NË LIDHJE ME KONFIRMIMIN E INTERVISTËS SË TË DYSHUARIT SI PROVË (HARAQIJA PIKAT 1 DHE 2)	19
VI. APELIMET KUNDËR DËNIMIT	25
A. APELI I MORINËS KUNDËR DËNIMI TË TIJ (PIKAT 8 DHE 9)	26
B. APELI I PROKURORISË	27
VII. VENDIM.....	29

1. Dhoma e Apelit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht, “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali Ndërkombëtar”) ka marrë tri apele paraqitur prej Astrit Haraqisë (“Haraqija”), Bajrush Morinës (“Morina”) dhe Prokurorisë kundër Aktgjykimit në lidhje me Akuzat për Shpërfillje të Tribunalit, shqiptuar prej Dhomës Gjyqësore I (“Dhoma Gjyqësore”) më 17 dhjetor 2008 në çështjen *Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore”).

I. HYRJE

A. Rrethana

2. Këto apele kanë të bëjnë me verdiktet e fajësisë së Morinës dhe Haraqisë për shpërfillje të Tribunalit Ndërkombëtar, bazuar në frikësimin prej tyre të Dëshmitarit 2, dëshmitar i mbrojtur në çështjen *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*. (“Çështja Haradinaj dhe të tjerë”). Aktakuza pasoi hetimin e urdhëruar prej Dhomës Gjyqësore bazuar në kërkesën e Prokurorisë në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* më 27 gusht 2007.¹

1. Bajrush Morina

3. Morina u lind më 10 dhjetor 1962 në Vegjë komuna e Rahovecit në Kosovë.² Gjatë periudhës së shqyrtuar në Aktakuzë, ai ishte këshilltar politik i Zëvendësministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.³

4. Morina u akuzuar formalisht më 12 tetor 2008, me një pike për shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar (“Rregullorja”).⁴ Në Aktakuzë deklarohet se Morina “me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyri në ushtrimin e drejtësisë përmes ndërhyrjes ndaj një dëshmitari të mbrojtur (“Dëshmitari 2”) në

¹ Trial Judgement/Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 4.

² Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 1.

³ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 1.

⁴ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paras 3, 7.

çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*.”⁵ Fill pasi mësoi për akuzat kundër tij dhe fletarrestin që u lëshuan më 25 prill 2008, ai iu dorëzua vullnetarisht Tribunalit Ndërkombëtar.⁶

5. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina ishte i vetëdijshëm se Dëshmitari 2 do të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*.⁷ Për më tepër u konkludua se më 10 korrik 2007, Morina takoi Dëshmitarin 2 dhe u orvat ta bindte që të mos dëshmonte. Në lidhje me këtë pikë Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina nxiti Dëshmitarin 2 që “të shpëtonte” Ramush Haradinajn⁸ duke mos dëshmuar, iu referua “pushtetit të fuqishëm të të tretëve”, dhe aludoi në lidhje me vrasjen e dëshmitarëve që kishin dëshmuar.⁹ Bazuar në këto veprime, Dhoma Gjyqësore e shpalli Morinën fajtor për shpërfillje të Tribunalit,¹⁰ dhe e dënoi me tre muaj burgim.¹¹

2. Astrit Haraqija

6. Haraqija u lind më 14 qershor 1972 në Gjakovë, komuna e Gjakovës, në Kosovë.¹² Gjatë periudhës së shqyrtuar në Aktakuzë ai ishte Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.¹³

7. Më 12 shkurt 2008, Haraqija u akuzua formalisht për shpërfillje të Tribunalit bazuar në Rregullën 77 (A)(iv) të Rregullores si dhe alternativisht për nxitje për shpërfillje të Tribunali.¹⁴ Në Aktakuzë deklarohet se Haraqija “me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyri në ushtrimin e drejtësisë duke ndërhyrë ndaj një dëshmitari të mbrojtur (“Dëshmitari 2”) në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*.”¹⁵ Në veçanti theksohet se Haraqija udhëzoi Morinën “që të organizonte një takim me Dëshmitarin 2, për ta bindur që të mos dëshmonte kundër Ramush Haradinajt.”¹⁶ Më 28 prill 2008, Haraqija iu dorëzua vullnetarisht Tribunalit Ndërkombëtar pasi u vu në dijeni të akuzave kundër tij.¹⁷

⁵ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 5 (nuk përfshihen citimet e brendshme).

⁶ Decision on Motion of Bajrush Morina for Provisional Release, 9 February 2009 (“Morina Provisional Release Decision”), paras 2, 5./Vendim në lidhje me Mocionin e Bajrush Morinës për Lirim të Përkohshëm, 9 shkurt 2009 (“Vendim për Lirimin e Përkohshëm të Morinës”), paras 2, 5.

⁷ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 55.

⁸ Z. Ramush Haradinaj (“Haradinaj”) ka qenë Kryeministër i Kosovës.

⁹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paras 56, 58, 60.

¹⁰ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paras 60, 61, 122(3).

¹¹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 122(4).

¹² Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 2.

¹³ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 2.

¹⁴ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paras 3, 7.

¹⁵ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 5 (nuk përfshihen citimet e brendshme).

¹⁶ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 6.

¹⁷ Decision on Motion of Astrit Haraqija for Provisional Release, 8 April 2009 (“Haraqija Provisional Release Decision”), paras 2, 7. / Vendim në lidhje me Mocionin e Astrit Haraqisë për Lirim të Përkohshëm, 8 prill 2009 (“Vendim për Lirimin e Përkohshëm të Haraqisë”), paras 2, 7.

8. Dhoma Gjyqësore konkludoi se “Haraqija dinte se Dëshmitari 2 ishte dëshmitar në procesin gjyqësor *Haradinaj dhe të tjerë* dhe udhëzoi Bajrush Morinën të kontaktonte Dëshmitarin 2 me detyrë konkrete ndërhyrjen në dhënien e dëshmisë prej tij.”¹⁸ Më tej u konkludua se veprimet e Haraqisë “ishin pjesë përbërëse e sjelljes kriminale të Bajrush Morinës” dhe rrjedhimisht e shpalli fajtor për shpërfillje të Tribunalit.¹⁹ Në bazë të fajësisë së tij ai u dënua me pesë muaj burgim.²⁰

B. Apelet

9. Morina dorëzoi Njoftimin e tij për Apel më 2 janar 2009, me nëntë pika apelimi kundër fajësisë dhe dënimit të tij.²¹ Morina dorëzoi dosjen e tij të Apeluesit më 19 janar 2009.²² Ai kërkon prej Dhomës së Apelit shfuqizimin e verdiktit të fajësisë së tij ose ndryshe uljen e dënimit.²³ Prokuroria dorëzoi Përgjigjen Përmbledhëse më 29 janar 2009.²⁴ Morina e dorëzoi Kundërpërgjigjen më 2 shkurt 2009.²⁵ Dhoma e Apelit e rrëzoi kërkesën e Morinës për shtimin e një pike në Njoftimin e tij për Apel dhe në dosjen e Apeluesit më 19 mars 2009.²⁶

10. Haraqija dorëzoi njoftimin e tij për apel më 2 janar 2009; ai parashtroi një apel prej shtatë pikash kundër fajësisë së tij.²⁷ Haraqija dorëzoi dosjen e Apeluesit më 19 janar 2009,²⁸ dhe

¹⁸ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 100.

¹⁹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paras 102, 122(1).

²⁰ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para. 122(2).

²¹ Njoftim për Apel në Emër të Bajrush Morinës, 2 janar 2009 (“Njoftim për Apel i Morinës”), paras 3-17.

²² Dosje e Apelit në Emër të Bajrush Morinës (konfidenciale), 19 janar 2009 (“Dosje e Apelit të Morinës”). Varianti publik u dorëzua më 23 qershor 2009.

²³ Njoftim për Apel i Morinës, paras 18, 19; Dosje e Apelit të Morinës, para. 84.

²⁴ Prosecution’s Consolidated Response Brief/Dosja Përmbledhëse e Përgjigjes së Prokurorisë (konfidenciale), 29 janar 2009. Siç përmendet më poshtë, Haraqija dorëzoi dy korigjues të dosjes së tij apeluese ku korigjohej numërtimi i paragrafëve. Më pas edhe Prokuroria dorëzoi një korigjues të dosjes së Përgjigjes së saj. Dhoma e Apelit i referohet variantit të korigjuar të dosjes bashkëngjitur korigjuesit. Shih Korigjuesin e Dosjes Përmbledhëse të Përgjigjes së Prokurorisë (konfidenciale), 26 shkurt 2009 (Shtojcë: Dosje Përmbledhëse e Korigjuar e Përgjigjes së Prokurorisë) (“Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë”). Varianti publik i Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë u dorëzua më 24 qershor 2009.

²⁵ Kundërpërgjigje e Bajrush Morinës ndaj “Dosjes Përmbledhëse të Përgjigjes së Prokurorisë” (konfidenciale), 2 shkurt 2009 (“Dosja e Kundërpërgjigjes së Morinës”).

²⁶ Vendim në lidhje me Kërkesën e Bajrush Morinës për Ndryshim të Pikave të Apelit, 19 mars 2009, para. 10.

²⁷ Njoftim i Astrit Haraqisë për Apelimin e “Aktgjykimit në lidhje me Akuzat për Shpërfillje” i Datës 17 dhjetor 2008, 2 janar 2009 (“Njoftim për Apel i Haraqisë”), paras 4-28. Njoftimi për Apel përmban tetë pika të apelit, mirëpo Haraqija hoqi një pikë të apelit në dosjen e tij të apeluesit. Dhoma e Apelit i referohet numërtimit në dosjen e apeluesit.

²⁸ Apeli i Astrit Haraqisë i “Aktgjykimit në lidhje me Akuzat për Shpërfillje” I Datës 17 dhjetor 2008 (konfidenciale), 19 janar 2009. Varianti publik u dorëzua më 6 shkurt 2009. Më pas Haraqija dorëzoi dy korigjues të dosjes së tij, duke korigjuar numërtimin e paragrafëve, përkatësisht më 20 janar 2009 dhe 10 shkurt 2009. Dhoma e Apelit i referohet variantit të korigjuar të përfshirë në shtojcën e Korigjuesit të Dytë të Apelit të Astrit Haraqisë të “Aktgjykimit në lidhje me Akuzat për Shpërfillje” i Datës 17 dhjetor 2008 me Shtojcë Konfidenciale (konfidenciale), 10 shkurt 2009 (“Dosja e Apelit të Haraqisë”).

kundërpërgjigjen ndaj Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë më 2 shkurt 2009.²⁹ Ai kërkon prej Dhomës së Apelit shfuqizimin e fajësisë së tij.³⁰

11. Prokuroria dorëzoi njoftimin e saj për apel më 2 janar 2009, duke parashtruar dy pika në apelin e vet kundër dënimeve të Dhomës Gjyqësore për Morinën dhe Haraqinë.³¹ Prokuroria dorëzoi dosjen e Apeluesit më 19 janar 2009.³² Prokuroria kërkon prej Dhomës së Apelit shtimin e dënimit të Morinës në një vit burgim dhe dënimin e Haraqisë në dy vjet burgim.³³ Morina dhe Haraqija dorëzuan Përgjigjet e tyre përkatësisht më 29 janar 2009.³⁴ Prokuroria dorëzoi dosjen e Kundërpërgjigjes përmbledhëse më 2 shkurt 2009.³⁵

C. Lirimi i Përkohshëm i Kushtëzuar

12. Dhoma e Apelit ka kompetencë të lirojë përkohësisht një person të shpallur fajtor gjatë pritjes së vendimit të apelit, nëqoftëse plotësohen kushtet e parashtruara në Rregullën 65(I) të Rregullores.³⁶ Duke mbajtur parasysh këto kritere, Dhoma e Apelit urdhëroi lirimin e përkohshëm të Morinës më 9 shkurt 2009 dhe të Haraqisë më 8 prill 2009.³⁷ Lidhur me lirimet, Dhoma e Apelit u bind se askush prej tyre nuk paraqiste rrezik arratisjeje dhe nuk përbënte rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjerë.³⁸ Gjithashtu u mor në konsideratë fakti se Morina dhe Haraqija mund të kishin përfunduar kryerjen e dënimit nëqoftëse nuk do të kishte patur apeline, si rethanë e veçantë që përligj lirimin.³⁹

²⁹ Kundërpërgjigje e Astrit Haraqisë ndaj “Dosjes Përmbledhëse të Përgjigjes së Prokurorisë” e Datës 29 janar 2009 (konfidenciale), 2 shkurt 2009 (“Dosje e Kundërpërgjigjes së Haraqisë”). Varianti publik u dorëzua më 6 shkurt 2009.

³⁰ Njoftim për Apel i Haraqisë, f. 9; Dosja e Apelit të Haraqisë, f. 23.

³¹ Njoftim për Apel i Prokurorisë, 2 janar 2009 (“Njoftim për Apel i Prokurorisë”).

³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, 19 janar 2009 (“Dosja e Apelit të Prokurorisë”).

³³ Njoftim për Apel i Prokurorisë, ff. 1, 2; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 17.

³⁴ Përgjigje e Bajrush Morinës ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 29 janar 2009 (“Dosja e Përgjigjes së Morinës”); Përgjigje e Astrit Haraqisë ndaj “Dosjes së Apelit të Prokurorisë” të Datës 19 janar 2009 (konfidenciale), 29 janar 2009 (“Dosje e Përgjigjes së Haraqisë”). Varianti publik i Dosjes së Përgjigjes së Haraqisë u dorëzua më 6 shkurt 2009.

³⁵ Dosja Përmbledhëse e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë (konfidenciale), 2 shkurt 2009 (“Dosje e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë”). Varianti publik u dorëzua më 9 shkurt 2009.

³⁶ Kushtet e Rregullës 65(I) janë: “(i) nëqoftëse lirohet, apeluesi do të paraqitet në seancën e apelit, ose do të dorëzohet në paraburgim në përfundim të periudhës së përcaktuar, sipas rastit; (ii) nëqoftëse lirohet apeluesi nuk do të përbëjë rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjerë, dhe (iii) ekzistojnë rrethanat të veçanta që përligjin lirimin.”

³⁷ Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Morinës, para. 12; Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Haraqisë, para. 15.

³⁸ Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Morinës, paras 7, 8; Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Haraqisë, paras 9, 10.

³⁹ Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Morinës, para. 10; Vendim i Lirimit të Përkohshëm të Haraqisë, para. 12. Dhoma e Apelit thekson se sipas Rregullës 102(A) të Rregullores, “menjëherë pas dhënies së njoftimit për apel, zbatimi i aktgjykimit pezullohet deri në shpalljen e vendimit të apelit, teksa personi i shpallur fajtor vazhdon të mbahet në paraburgim”.

D. Kërkesë për Argument Gojor

13. Më 6 shkurt 2009, Haraqija kërkoi seancë për diskutimin e disa argumenteve të përmendura në dosjen e tij që sipas tij cekin risi ligjore.⁴⁰ Prokuroria e kundërshton mocionin.⁴¹ Në Rregullën 116bis të Rregullores parashtrohet se për apelimin e një vendimi për shpërfillje të Tribunalit të dhënë sipas Rregullës 77 të Rregullores “mund të vendoset duke u bazuar tërësisht në parashtrimet me shkrim”. Gjithashtu Haraqija pohon se “çështjet e apeluara kanë të bëjnë me gabime të dukshme ligjore dhe faktuale që mund të zgjidhen në dobi të Mbrotjtjes thjesht mbi bazën e parashtrimeve me shkrim”.⁴² Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se argumenti gojor nuk është i nevojshëm dhe e rrëzon mocionin.

II. STANDARDET E SHQYRTIMIT

14. Dhoma e Apelit kujton standardet e shqyrtimit në apel sipas Nenit 25 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar (“Statuti”). Dhoma e Apelit shqyrton gabime ligjore që shfuqizojnë vendimin e Dhomës Gjyqësore dhe gabime faktuale që kanë shkaktuar dështim të drejtësisë. Ky standard shqyrtimi i vlefshëm për apelimet kundër aktgjykimeve, vlen edhe për apelimet kundër verdikteve të fajësisë për shpërfillje të Tribunalit.⁴³

15. Dhoma e Apelit shqyrton konkluzionet ligjore të Dhomës Gjyqësore për të përcaktuar saktësinë e tyre.⁴⁴ Pala që pretendon gabim ligjor, duhet të identifikojë gabimin e pretenduar, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të vet, dhe të shpjegojë se në çfarë mënyrë gabimi i pretenduar shfuqizon vendimin.⁴⁵ Në shqyrtimin e pretendimeve për gabime faktuale, Dhoma e Apelit do të përcaktojë nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte marrë vendimin

⁴⁰ Astrit Haraqija’s Request for Oral Argument on Appeal, 6 February 2009 (“Haraqija Request”)/Kërkesë e Astrit Haraqisë për Argument Gojor në lidhje me Apelin, 6 shkurt 2009 (“Kërkesa e Haraqisë”), paras 1, 8, 9.

⁴¹ Përgjigje e Prokurorisë ndaj “Kërkesës së Astrit Haraqisë për Argument Gojor në lidhje me Apelin”, 12 shkurt 2009, paras 1-5.

⁴² Kërkesa e Haraqisë, para. 8.

⁴³ *Contempt Proceedings Against Dragan Jokić*, Case No. IT-05-88-R77.1-A, Judgement on Allegations of Contempt, 25 June 2009 (“*Dragan Jokić Appeal Judgement*”), para. 11; *Prosecutor v. Josip Jović*, Case No. IT-95-14 & 14/2-R77-A, Judgement, 15 March 2007 (“*Jović Appeal Judgement*”), para. 11; *Prosecutor v. Ivica Marjačić and Markica Rebić*, Case No. IT-95-14-R77.2-A, Judgement, 27 September 2006 (“*Marjačić and Rebić Appeal Judgement*”), para. 15./*Procesi për Shpërfillje k. Dragan Jokiçit*, Lënda Nr. IT-05-88-R77.1-A, Aktgjykim në lidhje me Akuzat për Shpërfillje 25 qershor 2009 (“Aktgjykimi i Apelit Dragan Jokiç”) para 11; *Prokurori k. Josip Jovićit*, Lënda Nr. IT-95-14 & 14/2-R77-A, Aktgjykim, 15 mars 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Jović”) para 11; *Prokurori k. Ivica Marjaçiqit dhe Markica Rebiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-R77.2-A, Aktgjykim, 27 shtator 2006 (“Aktgjykimi i Apelit Marjaçiq dhe Rebiq”) para 15.

⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit Dragan Jokiç, para. 12; *Prosecutor v. Mile Mrkšić and Veselin Šljivančanin*, Case No IT-95-13/1-A, Judgement, 5 May 2009 (“*Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgement*”), para. 12/*Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Aktgjykim, 5 maj 2009 (“Aktgjykimi i Apelit Mërkshiq dhe Shlivançanin”), para 12; Aktgjykimi i Apelit Jović, para. 12; Aktgjykimi i Apelit Marjaçiq dhe Rebiq, para. 16.

⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit Dragan Jokiç, para. 12; Aktgjykimi i Apelit Mërkshiq dhe Shlivançanin, para. 11; Aktgjykimi i Apelit Jović, para. 12; Aktgjykimi i Apelit Marjaçiq dhe Rebiq, para. 15.

original.⁴⁶ Në përcaktimin nëse një konkluzion i Dhomës Gjyqësore ishte i logjikshëm, Dhoma e Apelit nuk do të ndërhyjë në përfundimet faktuale të Dhomës Gjyqësore kaq lehtësisht.⁴⁷

16. Dhoma e Apelit sjell në vëmendje se apeli nuk është rigjykim dhe gjatë apelit një palë nuk mund të përsërisë thjesht argumente që nuk patën sukses gjatë procesit gjyqësor, nëqoftëse kjo palë nuk mund të provojë se refuzimi i tyre shkaktoi një gabim të tillë që përlligj ndërhyrjen e Dhomës së Apelit.⁴⁸ Argumentet e një pale që nuk kanë të ngjarë të shkaktojnë shfuqizimin ose korrigjimin e vendimit të kundërshtuar, rrëzohen menjëherë prej Dhomës së Apelit pa u shqyrtuar meritat e tyre.⁴⁹ Dhoma e Apelit gëzon kompetencë në përzgjedhjen e atyre parashtrimeve që vlejnë një mendim të arsyetuar me shkrim dhe në hedhjen poshtë të argumenteve që janë qartësisht të pabazuara, pa dhënë arsyetim të hollësishëm.⁵⁰

III. PIKAT E PËRBASHKËTA TË APELIT

A. Pretendim për Gabim në Pranimin e Përgjimeve si Prova (Morina Pikat 1A dhe 2; Haraqija Pika 4)

17. Për shpalljen e fajësisë së Morinës dhe Haraqisë për shpërfillje të Tribunalit, Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi incizimet zanore dhe videofilmimet e bisedave më 10 dhe 11 korrik 2007, midis Morinës dhe Dëshmitarit 2.⁵¹ Policia e vendit ku u bënë bisedat⁵², pasi u këshillua me Prokurorinë, e pajisi Dëshmitarin 2 me aparate elektronike incizuese të fshehura, me qëllim për të incizuar fshehtësisht bisedat.⁵³ Sipas transkriptit të incizimeve, më 10 korrik 2008 Morina i tha Dëshmitarit 2 se Haraqija i kishte kërkuar të takonte Dëshmitarin 2 për t'i thënë që të tërhiqte

⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 16.

⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 16.

⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 17..

⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 17

⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 15.

⁵¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 14, 45, 47, 48, 55, 56, 77-79, 86.

⁵² Ashtu si Dhoma Gjyqësore, Dhoma e Apelit nuk e ka përmendur emrin e vendit për hir të sigurisë së dëshmitarit.

⁵³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 45; *Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Barush Morinës*, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim në lidhje me Kërkesën e Dytë të Morinës dhe Haraqisë për Deklaratë Papranueshërie dhe Përgjashtim të Provave (konfidenciale), 4 shtator 2008, para. 1. Më pas Dhoma Gjyqësore dorëzoi variant publik të ndryshuar të redaktuar të vendimit. *Shih Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim në lidhje me Kërkesën e Dytë të Morinës dhe Haraqisë për Deklaratë Papranueshmërie dhe Përgjashtim të Provave (Varianti i Ndryshuar i Redaktuar Publik), 27 nëntor 2008 ("Vendim për Përgjashtimin e Përgjimeve"), para. 1.

dëshminë.⁵⁴ Gjithashtu Morina aludoi për vrasjen e dëshmitarëve që kishin dëshmuar në Tribunalin Ndërkombëtar.⁵⁵

18. Më 4 shtator 2008, Dhoma Gjyqësore rrëzoi një mocion të përbashkët të mbrojtjes ku kërkohej papranueshmëria e materialit të siguruar fshehtazi, sipas Rregullave 89(D) dhe 95 të Rregullores, bazuar në pretendimin se ishte siguruar në shkelje të legjislacionit të vendit ku ishte incizuar.⁵⁶ Dhoma Gjyqësore konstatoi se palët kishin mosmarrëveshje përse i përket shkeljes së ligjit përkatës të vendit në lidhje me incizimet⁵⁷, por gjithsesi arsyetoi se edhe sikur përgjimet të ishin të paligjshme në legjislacionin e atij vendi, jurisprudenca e Tribunalit anon nga pranueshmëria, nëqoftëse provat kanë lidhje me çështjen dhe vlera e tyre provuese nuk zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës së garantimit të një gjykimi të drejtë.⁵⁸ Dhoma Gjyqësore u bind se në rrethanat ekzistuese, autoritetet vendore vepruan në mirëbesim për mbrojtjen e Dëshmitarit 2 dhe incizimet kishin lidhje me çështjen dhe vlerë provuese.⁵⁹

19. Morina argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor me pranimin e incizimeve zanore dhe videofilmimeve.⁶⁰ Po ashtu Haraqija kundërshton pranimin e incizimeve prej Dhomës Gjyqësore dhe adopton argumentet e Morinës.⁶¹ Veçanërisht Morina argumenton se incizimi i fshehtë i bisedave të tija me Dëshmitarin 2, shkeli të drejtën e respektit për jetën dhe korrespondencën e tij private sipas Nenit 8(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 17(1) të Komventës Ndërkombëtare për Të Drejtat Qytetare dhe Politike.⁶² Ai pretendon se ndërhyrja ndaj jetës së tij private prej një instance publike mund të përlligjet vetëm kur sipas Nenit 8(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është “në përputhje me ligjin” dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, për një prej qëllimeve të përmendura në atë paragraf.⁶³ Sipas Morinës, përcaktimi prej jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut i shprehjes “në përputhje me ligjin”, është kodi i përshtatshëm statutor.⁶⁴ Gjithashtu ai tërheq

⁵⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 48.

⁵⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 48.

⁵⁶ Vendim në lidhje me Përfashtimin e Përgjimeve, paras 7-9, 23, 30, 31.

⁵⁷ Vendim në lidhje me Përfashtimin e Përgjimeve, para. 19.

⁵⁸ Vendim në lidhje me Përfashtimin e Përgjimeve, para. 15.

⁵⁹ Vendim në lidhje me Përfashtimin e Përgjimeve, paras 20-22, 25, 26.

⁶⁰ Njoftim për Apel i Morinës, paras 3, 5, 6; Dosja e Apelit të Morinës, paras 15-37; Dosja e Kundërpërgjigjes së Morinës, paras 5-11.

⁶¹ Njoftim për Apel i Haraqisë, paras 14, 15; Dosja e Apelit të Haraqisë, paras 36, 37; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haraqisë, paras 12, 13.

⁶² Dosje e Apelit të Morinës, paras 17-22, 31; Dosje e Kundërpërgjigjes së Morinës, paras 5, 6, 10, 11.

⁶³ Dosje e Apelit të Morinës, para. 18.

⁶⁴ Dosje e Apelit të Morinës, para. 19.

vëmendjen në nevojën për garanci ligjore kur legjislacioni i një vendi dikton nevojën për një urdhëresë gjykatë.⁶⁵

20. Bazuar në sa më sipër, Morina argumenton se Prokuroria nuk vërtetoi se policia e atij vendi e kreu përgjimin e fshehtë në përputhje me legjislacionin përkatës të brendshëm, duke iu referuar veçanërisht një baze ligjore për incizimin e bisedave private.⁶⁶ Rrjedhimisht Morina argumenton se incizimet u bënë në shkelje të legjislacionit të brendshëm dhe për pasojë në shkelje të të drejtave të tij të sanksionuara prej Nenit 8(1) të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 17(1) të Konventës Ndërkombëtare për Të Drejtat Qytetare dhe Politike.⁶⁷ Lidhur me këtë ai u referohet kryesisht argumenteve të tija në procesin gjyqësor për ligjshmërinë e përgjimeve në legjislacionin përkatës të brendshëm.⁶⁸

21. Sipas Morinës prova të tilla janë të papranueshme sipas Rregullave 89(D) dhe 95 të Rregullores.⁶⁹ Ai u referohet qëndrimeve të “gjykatësve të shumtë” të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cituar në parashtrimet gjatë procesit gjyqësor, ku sugjerohet se procesi gjyqësor nuk mund të jetë i drejtë kur provat sigurohen duke shkelur të drejtat themelore të garantuara prej Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.⁷⁰ Rrjedhimisht duke marrë parasysh shkeljen e të drejtave të tij të garantuara ndërkombëtarisht, vlera provuese e përgjimeve si prova u zhvlerësua ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë dhe binte ndesh me ndershmërinë e procesit.⁷¹ Veçanërisht Morina pretendon se përdorimi i incizimeve të fshehta gjatë intervistës me të si i dyshuar, shkeli të drejtën e tij kundër vetëfajësimit, duke qenë se e detyroi të jepte një rrëfim të hollësishëm të cilin Dhoma Gjyqësore e shfrytëzoi si bazë për fajësimin e tij.⁷²

22. Megjithëse Morina pranon se Tribunali Ndërkombëtar ka pranuar si prova përgjime të kryera në shkelje të ligjit të vendit në të kaluarën, ai bën një dallim me rastin e mëparshëm duke theksuar se provat u siguruan gjatë një konflikti të armatosur.⁷³ Kurse ai u incizua në kohë paqeje në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, i cili sipas tij është i angazhuat për zbatimin e

⁶⁵ Dosje e Apelit të Morinës, para. 19.

⁶⁶ Dosje e Apelit të Morinës, para. 20.

⁶⁷ Dosje e Apelit të Morinës, paras 21, 22, 31.

⁶⁸ Dosje e Apelit të Morinës, paras 20-22.

⁶⁹ Dosje e Apelit të Morinës, paras 23-37; Dosje e Apelit të Morinës, para. 10.

⁷⁰ Dosje e Apelit të Morinës, para. 26. *See also* Dosja e Kundërpërgjigjes së Morinës, paras 6-9 (që i referohet vendimeve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare ku konkludohet se shkeljet e të drejtave të pranura ndërkombëtarisht përbëjnë arsye për përjashtimin e provave).

⁷¹ Dosje e Apelit të Morinës, paras 23-37; Dosje e Kundërpërgjigjes së Morinës, para. 6.

⁷² Dosje e Apelit të Morinës, paras 31-33.

⁷³ Dosje e Apelit të Morinës, para. 28.

standardeve të larta të të drejtave të njeriut të trajtuara prej Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.⁷⁴

23. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në pranimin e përgjimeve si prova dhe se, as Rregulla 89(D), as Rregulla 95 e Rregullores, nuk përlligjin përjashtimin e tyre.⁷⁵ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Haraqija nuk ka mundur të tregojë arsyen pse ai duhet të shfrytëzojë shkeljen e të drejtave të Morinës.⁷⁶

24. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se pranueshmëria e këtyre provave nuk varej prej respektimit të legjislacionit të një vendi.⁷⁷ Rregulla 89(C) e Rregullores përvijon kuadrin e përgjithshëm të pranueshmërisë së provave në Tribunalin Ndërkombëtar dhe i mundëson trupit gjykues të pranojë çfarëdo provash të rëndësishme që gjykon se kanë vlerë provuese. Nuk kundërshtohet fakti se incizimet e bisedave të Morinës me Dëshmitarin 2 kanë lidhje me çështjen dhe kanë vlerë provuese.

25. Rregulla 89(D) e Rregullores lejon një Dhomë të përjashtojë prova që kanë lidhje nëqoftëse vlera e tyre provuese zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë. Për më tepër Rregulla 95 e Rregullores pohon se nuk janë të pranueshme provat që sigurohen me anë të metodave që krijojnë dyshim thelbësor ndaj besueshmërisë së tyre, ose nëqoftëse pranimi i tyre bie ndesh ose cënon rëndë ndershmërinë e procesit.

26. Thelbi i argumenteve të Morinës dhe për analogji edhe atyre të Haraqisë,⁷⁸ kundër pranimi të këtyre provave, është se ato u morën prej policisë së atij vendi në shkelje të legjislacionit vendës. Mirëpo, as Haraqija, as Morina nuk e vërtetojnë këtë pretendim në apelet e tyre. Morina vetëm u referohet argumenteve të bëra gjatë procesit gjyqësor. Dhoma e Apelit ka konkluduar më herët në rrethana të ngjashme se “vetëm përmendja e argumenteve të bëra gjatë procesit gjyqësor për Dhomën e Apelit është e pamjaftueshme si argument në apelim”.⁷⁹ Rrjedhimisht Dhoma e Apelit nuk është e bindur se është vërtetuar se provat e përgjimeve u siguruan në kundërshtim me legjislacionin e vendit ku u bënë incizimet. Për pasojë nuk është i nevojshëm shqyrtimi i

⁷⁴ Dosje e Apelit të Morinës, paras 28-30.

⁷⁵ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 7-29.

⁷⁶ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 109.

⁷⁷ Konkretisht, Rregulla 89(A) e Rregullores parashtron se “një Dhomë [...] nuk u nënshtrohet rregullave shtetërore të provave”, dhe Rregulla 89(B) pohon se “një Dhomë zbaton rregullat e provave të cilat i shkojnë më së miri për shtat një vendimi të drejtë për çështjen para saj dhe përputhen me frymën e Statutit dhe parimet e përgjithshme të së drejtës.”

⁷⁸ Lidhur me argumentin e Prokurorisë se Haraqija nuk duhet lejuar t’i referohet shkeljes së pretenduar të të drejtave të Morinës si arsye për masë ndreqëse, Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi këtë çështje mbi bazën e parashtrimeve të përbashkëta të mbrojtjes. Gjithashtu nuk del prej vendimit apo parashtrimeve përkatëse se Prokuroria paraqiti kundërshtime në lidhje me këtë.

⁷⁹ *Prosecutor v. Radoslav Brdanin*, Case No. IT-99-36-A, Judgement, 3 April 2007, para. 35/*Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007, para.35.

argumenteve në lidhje me pretendimet për shkelje të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Politike dhe Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.

27. Në kundërshtim të argumenteve të Morinës, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut konkludon qartësisht se pranimi i materialeve të incizuara fshehtazi, edhe kur bëhet në shkelje të Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jo domosdoshmërisht bie ndesh me kushtet për një gjykim të drejtë, veçanërisht kur i akuzuari ka mundësi ta kundërshtojë autenticitetin dhe përdorimin e materialit, kur nuk ka dyshim për besueshmërinë ose saktësinë e tij dhe kur provat janë mjaft bindëse dhe të konfirmuara nga materiale të tjera.⁸⁰ Siç u thekua edhe më sipër, këto kritere janë plotësuar.

28. Gjithsesi, edhe sikur bisedat e 10 dhe 11 korrikut 2007 të jenë incizuar në shkelje të legjislacionit të brendshëm, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Rregulla 89(D) ose Rregulla 95 të Rregullores kërkojnë përjashtimin e tyre. Në refuzimin e kërkesës për përjashtimin e këtyre provave, Dhoma Gjyqësore theksoi se palët nuk kundërshtuan lidhjen e tyre me çështjen ose vlerën e tyre provuese.⁸¹ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore mori parasysh rrethanat e mbledhjes së provave dhe konstatoi se autoritetet vendëse vepruan në “mirëbesim” për garantimin e dëshmitarit të mbrojtur kundrejt rrethanave të procesit gjyqësor që po ndodhte “në një atmosferë ku dëshmitarët ndiheshin të pasigurtë”.⁸² Nëqoftëse rrëfimi i Dëshmitarit 2 për bisedat e tij të ndryshme nuk përbën shkelje të privatësisë së Morinës, Dhoma e Apelit gjykon se përdorimi i incizimit të tyre të saktë në procesin gjyqësor, nuk vë në pikëpyetje ndershmërinë e procesit. Rrjedhimisht në lidhje me këtë rast, Dhoma e Apelit nuk është bindur se Dhoma Gjyqësore gaboi kur pranoi dhe shfrytëzoi bisedat e incizuara. Si pasojë Dhoma e Apelit nuk është bindur as se përdorimi i këtij materiali gjatë intervistës së Morinës si i dyshuar, ishte i papërshtatshëm.

29. Rrjedhimisht pikat e mësipërme të apelit hidhen poshtë.

⁸⁰ See, e.g., *Case of Bykov v. Russia*, Application No. 4378/02, Judgment, 10 March 2009, paras 84-105; *Case of Khan v. The United Kingdom*, Application No. 35394/97, Judgment, 12 May 2000, paras 29-40; *Case of Schenk v. Sëitserland*, Application No. 10862/84, Judgment, 12 July 1988, paras 39-49. *Çështja Bykov k. Rusisë*, Kërkesë Nr. 4378/02, Aktgjykim, 12 maj 2000, paras 84-105; *Çështja Khan k. Britanisë së Madhe*, Kërkesë Nr. 35394/97, Aktgjykim, 10 mars 2009, paras 29-40; *Çështja Schenk k. Zvicrës*, Kërkesë Nr. 10862/84 Aktgjykim, 12 korrik 1988, paras 29-40.

⁸¹ Vendim në lidhje me Përjashtimin e Përgjimeve, paras 21, 22.

⁸² Vendim në lidhje me Përjashtimin e Përgjimeve, para. 20 (nuk përfshihen citimet e brendshme).

B. Pretendim për Gabim në Pranimin e Intervistës së Të Dyshuarit (Morina Pika 3; Haraqija Pika 3)

30. Më 26 tetor 2007 Prokuroria intervistoi Morinën në zyrën e saj rajonale në Prishtinë.⁸³ Ai nuk pati ndihmën e avokatit.⁸⁴ Intervista u incizua, dhe transkripti së bashku me incizimin zanor iu dhanë Morinës pas paraqitjes së tij të parë më 29 prill 2009.⁸⁵ Më 5 dhe 14 gusht 2008, Prokuroria paraqiti variantet e korigjuara të transkriptit pas rishikimit prej një ndihmësi gjuhësor shqipfolës.⁸⁶ Më 28 gusht 2008, Dhoma Gjyqësore refuzoi kërkesat e Morinës dhe Haraqisë për deklarimin e transkriptit të intervistës të papranueshëm.⁸⁷ Dhoma Gjyqësore konkludoi se të tëra garancitë procedurale në lidhje me intervistat e të dyshuarit ishin respektuar dhe se Morina kishte hequr dorë vullnetarisht prej të drejtës për avokat.⁸⁸ Më 14 tetor 2008, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi sërish çështjen e heqjes dorë prej të drejtës, për shkak të një gabimi në transkriptimin e një pjese thelbësore të intervistës dhe arriti në të njëjtin përfundim.⁸⁹ Në vijim Dhoma Gjyqësore u mbështet në intervistën e të dyshuarit kur konkludoi se Haraqija e kishte udhëzuar Morinën të takonte Dëshmitarin 2 për ta bindur që të mos dëshmonte.⁹⁰

31. Morina argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur pranoi si provë intervistën e të dyshuarit.⁹¹ Morina argumenton në veçanti se ai nuk u informua si duhej për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij para se të merrej në pyetje.⁹² Gjithashtu Morina vë në dukje paqartësitë në transkriptin e intervistës që sipas tij tregojnë se ai nuk hoqi dorë vullnetarisht prej të drejtës për avokat.⁹³ Në këto rrethana, Morina argumenton se rrjedhimisht intervista e të dyshuarit duhej konsideruar e papranueshme bazuar në Rregullat 89(D) dhe 95.⁹⁴ Edhe Haraqija e kundërshton pranimin e intervistës prej Dhomës Gjyqësore dhe adopton argumentet e Morinës.⁹⁵

⁸³ *Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim në lidhje me Kërkesën e Bajrush Morinës për Deklarim Papranueshmërie dhe Përfundim të Provave, 28 gusht 2008 (“Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit”), para. 2.

⁸⁴ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, para. 26.

⁸⁵ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, para. 3.

⁸⁶ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, para. 4.

⁸⁷ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, para. 38.

⁸⁸ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, paras 25-31.

⁸⁹ *Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim në lidhje me Kërkesën e përbashkët të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës për Rishqyrtimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 28 gushtit 2008, 14 tetor 2008 (“Vendimi për Rishqyrtim në lidhje me Intervistën e të Dyshuarit”), paras 12-16.

⁹⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 49.

⁹¹ Njoftim për Apel i Morinës, para. 7; Dosje e Apelit të Morinës, paras 42-50.

⁹² Dosje e Apelit të Morinës, paras 42, 45, 47, 50.

⁹³ Dosje e Apelit të Morinës, paras 45, 46.

⁹⁴ Dosje e Apelit të Morinës, paras 48, 49.

⁹⁵ Njoftim për Apel i Haraqisë, paras 10, 11; Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 34, 35.

32. Prokuroria përgjigjet se incizimi i intervistës me të dyshuarin tregon qartësisht se Morina u informua si duhej dhe hoqi dorë prej të drejtës për avokat.⁹⁶ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Haraqija nuk ka vërtetuar pse duhet të mbështetet në shkeljen e të drejtave të Morinës.⁹⁷

33. Neni 18(3) i Statutit dhe Rregulla 42(A) e Rregullores sanksionojnë të drejtën e të dyshurit për avokat, kur merret në pyetje prej Prokurorisë gjatë një hetimi.⁹⁸ Rregulla 42(A) e Rregullores më tej kërkon që Prokuroria të informojë të dyshuarin për këtë të drejtë, ndër të tjera para marrjes në pyetje. Rregulla 42(B) ndalon Prokurorinë që të marrë në pyetje një të dyshuar “pa praninë e avokatit nëqoftëse i dyshuari nuk ka hequr dorë vullnetarisht prej të drejtës për avokat.”⁹⁹

34. Siç konstatoi Dhoma Gjyqësore, në fletëthirrjen për intervistë shkruhej se Morina ishte i dyshuar dhe u bashkëngjit një kopje e Nenit 18, ku ndër të tjera përmendet e drejta e tij për avokat gjatë intervistës.¹⁰⁰ Gjithashtu në fillim të intervistës, hetuesi e informoi Morinën se ai ishte i dyshuar dhe se kishte të drejtën që të mos fliste dhe të kishte avokat të zgjedhur prej të tij, ose që mund t’i caktohej, nëqoftëse nuk mund të paguante.¹⁰¹ Morina deklaroi se e kuptoi këtë.¹⁰² Më tej hetuesi qartësoi se një përkthyes shqiptar ishte në disponim dhe se Morina mund t’u përgjigjej pyetjeve në shqip ose anglisht.¹⁰³

⁹⁶ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 36-42.

⁹⁷ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 108.

⁹⁸ Neni 18(3) i Statutit parashtroi se “nëqoftëse merret në pyetje, i dyshuari ka të drejtë të ndihmohet prej një avokati të zgjedhur prej tij, përfshirë të drejtën për dhënien e ndihmës juridike pa pagesë nëqoftëse atij i mungojnë fondet e mjaftueshme për të paguar si dhe përkthimin e nevojshëm në një gjuhë dhe prej një gjuhe që ai e flet dhe kupton.” Rregulla 42(A) e Rregullores parashtroi: “Një i dyshuar i cili do të merret në pyetje nga Prokuroria ka këto të drejta për të cilat ai/ajo informohet nga Prokuroria para marrjes në pyetje në një gjuhë që i dyshuari e kupton: (i) e drejta për t’u ndihmuar nga një avokat i zgjedhur nga i dyshuari ose dhënia e ndihmës juridike pa pagesë nëqoftëse i dyshuari nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar për të; (ii) e drejta e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi nëqoftëse i dyshuari nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që do të përdoret gjatë marrjes në pyetje; dhe (iii) e drejta për të heshtur dhe për t’u paralajmëruar se çdo deklaratë e të dyshuarit incizohet dhe mund të përdoret si provë.”

⁹⁹ Në Rregullën 42(B) të Rregullores lexohet: “Marrja në pyetje e të dyshuarit nuk fillon pa praninë e avokatit mbrojtës, përveç nëse i dyshuari ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta për avokat. Pasi ka hequr dorë nga e drejta për avokat, nëqoftëse më pas i dyshuari shpreh dëshirën që të ketë avokat, marrja në pyetje ndërpritet dhe rifillon vetëm kur i dyshuari ka siguruar avokat ose i është caktuar avokat.”

¹⁰⁰ Vendim në lidhje me Intervistën e Të Dyshuarit, paras 19, 26. Për më tepër Dhoma e Apelit konstaton se Morina theksoi në intervistë se e kishte lexuar fletëthirrjen në shqip dhe në anglisht të cilën e kupton. Shih Proven Materiale 19 të Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), ff. 33, 34.

¹⁰¹ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), f. 1 (“Bazuar në informacionin që ka Tribunali, Prokurori i Tribunalit mendon se mund të jeni i dyshuar, përgjegjës për kryerjen e veprimeve që mund të jenë të dënueshme në Statutin e Tribunalit. Për një minutë kolegu im do të japë hollësi në lidhje me informacionin që kemi mirëpo para se t’ju bëjmë pyetje të tjera unë kam detyrë t’ju informoj për disa të drejta që keni sepse konsideroheni i dyshuar i mundshëm. A kuptoni deri këtu? A po shprehem qartë? Nuk jeni detyruar të thoni gjë apo t’u përgjigjeni pyetjeve në rast se nuk dëshironi. Çdo gjë që do të thoni, do të incizohet dhe mund të përdoret si provë kundër jush në një fazë të mëvonshme të procesit të Tribunalit, edhe gjatë gjyqimit. Pyetjet që do t’ju bëjmë dhe çfarëdo përgjigje që do të jepni do të incizohen dhe në fund të intervistës do t’ju jepet një kopje e incizimit. Keni të drejtë të ndihmoheni prej një përfaqësuesi ligjor ose prej një avokati të zgjedhur prej jush. Nëqoftëse nuk jeni në gjendje të paguani mbrojtjen ligjore, Tribunali do të kujdeset për këtë, falas për ju. A kuptuat gjithë çkam thënë deri tani.”).

¹⁰² Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervistë e të dyshuarit), f. 2.

¹⁰³ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervistë e të dyshuarit), f. 2.

35. Pas kësaj, hetuesi theksoi se Morina nuk kishte avokat dhe deklaroi se intervista do të vazhdonte në rast se ai hiqte dorë prej të drejtës për avokat; pastaj Morina u pyet nëse dëshironte të vazhdonte.¹⁰⁴ Në dialogun e mëposhtëm është përgjigjia e Morinës si dhe pëlqimi i tij i qartë për vazhdimin e intervistës:

BM/int: (Ndihmësi gjuhësor: BM aktualisht thotë: “Nuk e njoh aktakuzën, arsyen pse jam i dyshuar, kështu që për të shpejtuar procesin, për momentin nuk e gjykoj të nevojshme, mirëpo ? ndërkohë? ? ndo kohë? mund të jetë e nevojshme. Thjesht nuk di për çka akuzohem.”)(Ndihmësi gjuhësor: BM përdor “ndërkohë” që do të thotë “meanwhile” ose “Ndo kohë” që do të thotë “eventually”.

BM: (në anglisht) Maybe, [maybe].¹⁰⁵

PMB: Ju takon juve të zgjidhni. Nëqoftëse në ndonjë moment dëshironi praninë e avokatit këtu me ju, ne mund ta ndërpresim intervistën dhe e rregullojmë ... ju japim kohë që të rregulloni që avokati të jetë i pranishëm. Qëllimi i intervistës është ky: Dhoma Gjyqësore në çështjen HARADINAJ, Ramush HARADINAJ, ka urdhëuar kryerjen e një hetimi për shpërfillje të mundshme të Tribunalit, në të cilën mund të jetë kontaktuar një dëshmitar i mundshëm në atë çështje dhe ndaj të cilit mund të jetë ushtruar ndikim që ose të japë dëshmi të rreme ose të mos dëshmojë. Në këtë fazë ne mendojmë se mund të na ndihmoni në hetimin e çështjes prej nesh dhe përgjithësisht kjo është arsyeja pse dëshirojmë të bisedojmë me ju.

BM/Int. Me të vërtetë nuk kuptova. Ju po thoni se kam ushtruar presion ndaj dëshmitarëve për të mos dëshmuar ?

PMB: Po, mendojmë se një prej dëshmitarëve të mundshëm në këtë çështje është kontaktuar dhe ndaj tij është ushtruar ndikim nëse do të dëshmojë apo nuk do të dëshmojë në këtë çështje.

BM/Int: Dhe jam unë personi që ka ndikuar dëshmitarin?

PMB: Dimë se ju jeni personi që vizitoi këtë dëshmitar dhe foli me të. Dëshmitari quhet [...]. A është më e qartë?

BM/Int: E njihja këtë person.

PMB: A pranoni të vazhdojmë intervistën?

BM/Int: / INT I palexueshëm/ (Ndihmësi gjuhësor: BM thotë “Po, patetër”, që në anglisht përkthehet “Yes, of course/ Yes, certainly”).¹⁰⁶

36. Thelbi i argumentit të Morinës, dhe për analogji i Haraqisë,¹⁰⁷ është pretendimi se Prokuroria duhej të informonte Morinën për llojin e hetimit para se ta informonte për të drejtën e tij

¹⁰⁴ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervistë e të dyshuarit), f. 2 (“Para se të fillojmë pjesën formale të intervistës, dëshiroj veç të bëj të qartë se në bazë të rregullores, jeni i dyshuar, intervista nuk do të vazhdojë pa praninë e avokatit, qoftë përfaqësuesi juaj ligjor, apo avokati juaj, dhe do të vazhdojmë vetëm nëse hiqni dorë prej të drejtës suaj për praninë e avokatit. Për momentin ju jeni vetëm këtu pa praninë e avokatit. Atëherë, dëshironi të vazhdojmë me intervistën?”).

¹⁰⁵ Pasi shqyrtoi pjesën zanore të incizimit, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina deklaroi “maybe, maybe” dhe jo “maybe, later”, fakt që pasqyrohet në transkriptin e intervistës Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), f. 2). *Shih* Vendimin për Rishikimin e Intervistës me Të Dyshuarin, para. 12.

¹⁰⁶ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), ff. 2, 3.

¹⁰⁷ *Shih më sipër* psh. 78.

për avokat.¹⁰⁸ Ai argumenton se përgjigjja e tij fillestare kur u pyet nëse donte të vazhdonte intervistën tregon se ai nuk ishte “në gjendje të vlerësonte nëse i nevojitej ndihma e avokatit.”¹⁰⁹ Sipas Morinës, Prokuroria ishte e detyruar ta rikujtonte për të drejtën për avokat pasi ta informonte për llojin e hetimit dhe jo thjesht të pyeste: “A pranoni të vazhdoni intervistën”.¹¹⁰ Dhoma e Apelit nuk pajtohet me këtë argument.

37. I dyshuaru duhet të informohet për llojin e hetimit para intervistës në mënyrë që të marrë një vendim të bazuar mbi informacion në lidhje me heqjen dorë prej të drejtave të tij. Shqyrtimi i transkriptit të intervistës tregon se ky kusht është plotësuar. Në këtë kontekst Prokuroria informoi Morinën për të drejtat e tij dy herë para se ai të pyetej nëse dëshironte të hiqte dorë prej të drejtës për avokat. Pasi pohoi se i kuptonte të drejtat e tij, Morina u përgjigj duke pyetur për llojin e hetimit të cilit Prokuroria iu përgjigj fill pasi e kishte informuar atë për herë të tretë për të drejtat e tij. Dhoma e Apelit nuk është bindur se Prokuroria duhej të informonte Morinën për herë të katërt në lidhje me të drejtën e tij për avokat, veçanërisht pas një shkëmbimi kaq të shkurtër. Përgjigjja e Morinës “Po, natyrisht/ Po, sigurisht” ndaj pyetjes nëse dëshironte të vazhdonte, është e qartë.¹¹¹ Për pasojë Dhoma e Apelit nuk bindet se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ishin respektuar të tëra garancitë procedurale dhe se Morina hoqi dorë vullnetarisht prej të drejtës së tij për avokat.

38. Rrjedhimisht këto pika të apelit rrëzohen.

IV. APELI I BAJRUSH MORINËS

A. Pretendim për Gabime nëpërmjet Keqinterpretimit të Provave të Përgjimeve (Morina

Pika 1B)

39. Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi bisedën e 10 korrikut 2007, incizuar fshehtëazi, kur konkludoi se Morina përdori frikësimin për t’i bërë thirrje Dëshmitarit 2 që të mos dëshmonte kundër Ramush Haradinajt.¹¹² Për këtë pikë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina aludoi për “pasoja të rënda negative” të dhënies së dëshmisë, duke përmendur konkretisht një dëshmitar të mbrojtur i cili refuzoi të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* “meqenëse të tërë dëshmitarët janë vrarë”

¹⁰⁸ Dosja e Apelit të Morinës, paras 42, 45-47, 49.

¹⁰⁹ Dosja e Apelit të Morinës, para. 45.

¹¹⁰ Dosja e Apelit të Morinës, paras 45, 46, 49.

¹¹¹ Morina sugjeron se përgjigjja e tij ishte thjesht “OK”. *Shih* Dosjen e Apelit të Morinës, para. 45. Transkripti i rishikuar i cituar më lart, qartëson se ai tha “Po natyrisht/ Po, sigurisht”. Gjithsesi, edhe “OK” mund të jetë përgjigje pohuese në kontekst.

¹¹² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 48, 56, 58, 60.

dhe për shkak të familjes së dëshmitarit.¹¹³ Sipas Dhomës Gjyqësore, pasi përmendi këtë, “Morina përmendi edhe shembuj të tjerë konkretë të dëshmitarëve të kërcënuar apo madje edhe të vrarë.”¹¹⁴

40. Morina argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual kur keqinterpretoi përmbajtjen e bisedës.¹¹⁵ Sipas Morinës biseda “thjesht tregon dy miq prej Kosovës që diskutojnë rrethanat dhe zhvillimet politike në vendin e tyre” dhe nuk ekziston asnjë sugjerim për “pasoja negative” për Dëshmitarin 2 për dhënie dëshmie në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*.¹¹⁶ Gjithashtu ai argumenton se për këtë pikë nuk pati prova konfirmuese.¹¹⁷ Më tej Morina parashtroi se Dhoma Gjyqësore gabimisht deklaroi se ai kishte përmendur shembuj të tjerë konkretë të dëshmitarëve të kërcënuar ose të vrarë kur faktikisht ishte Dëshmitari 2 ai që solli shembuj të tjerë.¹¹⁸

41. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk i keqinterpretoi komentet e Morinës.¹¹⁹ Sipas Prokurorisë, argumentet e Morinës “injorojnë faktin se Morina i tha Dëshmitarit 2 se ishte dërguar për t’a bindur që të mos dëshmonte.”¹²⁰ Prokuroria gjithashtu argumenton se në fakt Morina përmendi së paku një shembull tjetër të një dëshmitari që refuzoi të dëshmonte, por edhe sikur Dhoma Gjyqësore të ketë gabuar në atë poshtëshënim, konkluzioni i saj përfundimtar u bazua në një deklaratë të pakundërshtuar të Morinës.¹²¹

42. Shqyrtimi i transkriptit të bisedës së 10 korrikut 2007 tregon qartë se Morina përmendi një dëshmitar të mbrojtur që tërhoqi dëshminë në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* “meqenëse të tërë dëshmitarët ishin vrarë”.¹²² I marrë veçazi, ky koment mund të interpretohet ashtu siç thotë Morina, si diskutimi midis dy miqve të vjetër për situatën politike në Kosovë. Mirëpo pak para këtij komenti, Morina tregoi se disa individë në Kosovë “po përpiqeshin të gjenin një mënyrë për të mbrojtur Ramush Haradinajn”.¹²³ Ai theksoi se ishin identifikuar tre individë, ndër të cilët Dëshmitari 2, të cilët mund “të shpëtonin” Haradinajn.¹²⁴ Morina shtoi se në lidhje me një individ, u tha se ai ishte “kokëtrashë” dhe “[ai] veç është për t’u vra sepse askush” me gjasë nuk mund të

¹¹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 48, ku citohet Prova Material 12 e Prokurorisë(biseda e 10 korrikut 2007), f. 23 (“[një dëshmitar] u tërhoq prej dhënies së dëshmisë, [pasi kishte dëshmuar në një çështje tjetër] si dëshmitar i mbrojtur kundër Ramushit, ai doli haptas dhe tha se nuk dëshironte të dëshmonte sepse në Kosovë kishin ndodhur gjithfarëlloj krimesh, çfarë kam shkruar, është e vërtetë, tani unë /I padëgjueshëm/ sepse të gjithë dëshmitarët janë vrarë, kam familje dhe nuk dua të dëshmoj [...]”).

¹¹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 48, fn. 92.

¹¹⁵ Njoftim për Apel i Morinës, para. 4; Dosje e Apelit të Morinës, paras 38-41.

¹¹⁶ Dosje e Apelit të Morinës, para. 39.

¹¹⁷ Dosje e Apelit të Morinës, para. 39.

¹¹⁸ Dosje e Apelit të Morinës, paras 40, 41.

¹¹⁹ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 30-35.

¹²⁰ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 32.

¹²¹ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 34.

¹²² Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 23.

¹²³ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 20.

¹²⁴ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 21.

fliste me të.¹²⁵ Mirëpo për Dëshmitarin 2, ata thanë “kë mund të gjejmë për të, kë duhet të marrim”.¹²⁶ Morina vuri në dukje se duke qenë se ai e njohte Dëshmitarin 2, Haraqija e kontaktoi që t’i thoshte dëshmitarit “të tërhiqte aktakuzën kundër Ramushit”.¹²⁷ Pastaj Morina pohoi se ai i tha Haraqisë “të mos përhapte fjalë se [Dëshmitari 2 po] dëshmonte, tash nuk është mirë, edhe sikur të jetë a të mos jetë e vërtetë”.¹²⁸ Fill pas kësaj thënieje, Morina dha shembullin e cituar prej Dhomës Gjyqësore për një dëshmitar të mbrojtur që kishte refuzuar të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* për shkak të frikës së vrasjes.

43. Dhoma e Apelit nuk bindet prej shpjegimit të Morinës për komentin mirëdashës. Është e qartë se ai nuk ndodhej atje thjesht si mik i vjetër për të biseduar për politikë, por si lajmëtar. Nëqoftëse komenti shihet në kontekstin e duhur, Dhoma e Apelit bindet se Dhoma Gjyqësore konkludoi logjikisht se ai aludoi për “pasojë të rëndë negative” nëqoftëse Dëshmitari 2 do të dëshmonte.¹²⁹

44. Sugjerimi i Morinës se ky konkluzion nuk u konfirmua, është pa bazë. Kur konkludoi se veprimet e Morinës përbënin frikësim, Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi dëshminë e Dëshmitarit 2, i cili u pyet nga Mbrojtja në lidhje me vijimësinë e ngjarjeve.¹³⁰ Gjithashtu biseda që përbën thelbin e krimit, u incizua fshehtësisht dhe u transkriptua dhe saktësia e saj nuk është kundërshtuar.¹³¹ Transkriptet u dorëzuan së bashku me kopje të mesazheve prej telefonit mobil të Morinës në lidhje me takimin, nëpërmjet dëshmisë së Dëshmitarit 1, i cili ishte përgjegjës për sigurinë e Dëshmitarit 2 dhe mori pjesë në përgjim.¹³² Dhoma e Apelit bindet se transkripti i bisedës konfirmohet mjaftueshëm.

45. Në lidhje me “shembuj të tjerë konkretë të dëshmitarëve të kërcënuar ose edhe të vrarë”,¹³³ Dhoma e Apelit theksoi se dy herë në pjesën përkatëse të transkriptit, Morina përmendi një dëshmitar që refuzoi të dëshmonte.¹³⁴ Duket se argumentet e Morinës sugjerojnë se bëhet fjalë për të njëjtin person, megjithëse u përmendën emra të ndryshëm.¹³⁵ Në kundërshtim me argumentet e Prokurorisë, shqyrtimi më i hollësishëm i transkriptit si dhe i intervistës me të dyshuarin lidhur me

¹²⁵ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 22.

¹²⁶ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 22.

¹²⁷ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 22.

¹²⁸ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 22.

¹²⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore. 60.

¹³⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 42-49.

¹³¹ *Shih më sipër* Nënkapitulli III.A (Morina, Pikat 1A dhe 2; Haraqija, Pika 4: Pretendim për Gabim në Pranimin e Përgjimeve si Prova).

¹³² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 45. *Shih edhe* T. 46, 52, 55.

¹³³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 48, psh. 92.

¹³⁴ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), ff. 22, 23.

¹³⁵ Dosje e Apelit të Morinës, para. 40.

atë pjesë të bisedës, zbulon se sugjerimi i Morinës ka bazë.¹³⁶ Në fakt transkripti tregon se Dëshmitari 2 dha shembull tjetër konkret pas komentit të Morinës.¹³⁷ Mirëpo edhe sikur Dhoma Gjyqësore të kishte gabuar në këtë pikë, konstatimi u përfshi në një poshtëshnim dhe nuk duket se është themeli i konkluzioneve të saj. Rrjedhimisht Morina nuk ka treguar se ky gabim rezultoi në dështim të drejtësisë.

46. Si pasojë kjo pikë e apelit rrëzohet.

B. Pretendim për Gabime në Konkluzionin se Morina Kreu Shpërfillje (Morina, Pikat 4-7)

47. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina dinte se Dëshmitari 2 do të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. Gjithashtu u konkludua se:

Gjatë takimit të 10 korrikut, Bajrush Morina shpjegoi se ai ishte dërguar ta bindte Dëshmitarin 2 që të mos dëshmonte në Tribunal. Gjithashtu ai bëri të ditur se Dëshmitari 2 ishte personi i cili po të refuzonte të dëshmonte, mund “të shpëtonte” Ramush Haradinajn. Së fundi Bajrush Morina përmendi edhe vrasjet e individëve që kishin vendosur të dëshmonin.¹³⁸

Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se “fjalët e Bajrush Morinës synonin dhe mund të kuptoheshin vetëm si thirrje e fortë dhe e qartë ndaj Dëshmitarit 2, duke iu referuar pushtetit të fuqishëm të të tretëve dhe duke aluduar për pasoja të rënda negative, që të mos dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*.”¹³⁹ Rrjedhimisht u konkludua se sjellja e Morinës gjatë takimit të 10 korrikut 2007 përbënte frikësim, që përcaktohet në Rregullën 77(A)(iv) të Rregullores.

48. Morina argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktual kur konkludoi se ai kreu shpërfillje.¹⁴⁰ Morina kundërshton përfundimin se ai kishte dijeni që Dëshmitari 2 do të paraqitej në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, duke iu referuar mospërputhjeve të deklaratave të Dëshmitarit 2 në lidhje me këtë.¹⁴¹ Gjithashtu ai kundërshton se i vetmi konkluzion logjik prej provave ishte se sjellja e tij përbënte frikësim dhe se ai veprroi me synimin e kërkuar.¹⁴² Në këtë pikë, Morina përsërit kundërshtim e tij ndaj pranimi të transkripteve të intervistës së tij si i dyshuar dhe të incizimit të bisedës së 10 korrikut 2007.¹⁴³ Gjithashtu ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë prova të profesionalizmit të tij dhe se ai kishte një qëllim të ligjshëm për udhëtimin në vendin ku ndodhej Dëshmitari 2, gjegjësisht botimin e një artikulli për udhëtimet e tij

¹³⁶ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 22, rrsh. 33, f. 23, rrsh. 2-12, 22-28; Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), ff. 19, 20.

¹³⁷ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), f. 23, rrsh. 29.

¹³⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 56 (nuk përfshihen citimet e brendshme).

¹³⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 60.

¹⁴⁰ Njoftim për Apel I Morinës, paras 9-14; Dosje e Apelit të Morinës, paras 51-72.

¹⁴¹ Dosje e Apelit të Morinës, paras 56-59.

¹⁴² Dosje e Apelit të Morinës, paras 51-68.

¹⁴³ Dosje e Apelit të Morinës, para. 62.

dhe verifikimin e vërtetësisë së një interviste që dëshmitari i kishte dhënë më parë.¹⁴⁴ Gjithashtu Morina u referohet provave se ai nuk ishte përkrahës i Haradinajt dhe faktikisht më parë kishte shkruar artikuj kritikë ndaj tij.¹⁴⁵ Së fundi, ai pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi nëse ai kishte motiv për kryerjen e shkeljes.¹⁴⁶

49. Prokuria përgjigjet se argumentet e Morinës janë të pabaza dhe nuk provojnë se Dhoma Gjyqësore nxorri konkluzione të paarsyeshme.¹⁴⁷

50. Shqyrtimi i konkluzionit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me dijeninë e Morinës se Dëshmitari 2 ishte dëshmitar në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* tregon se ajo shfrytëzoi kryesisht transkriptet e bisedës së Morinës të 10 korrikut 2007 dhe të intervistës së tij si i dyshuar, veç dëshmisë së Dëshmitarit 2.¹⁴⁸ Dhoma e Apelit ka refuzuar kundërshtimin e Morinës ndaj pranimi të transkripteve të bisedës dhe intervistës.¹⁴⁹ Për më tepër këto dokumente tregojnë qartësisht dijeninë e tij për statusin e Dëshmitarit 2. Për pasojë ai nuk ka treguar se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me dijeninë e tij ishte i paarsyeshëm. Gjithsesi Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dhe rrëzoi argumentet lidhur me ndryshimet në deklaratat e Dëshmitarit 2 në lidhje me faktin nëse Morina e pyeti dëshmitarin para takimit kur do të shkonte në Hagë.¹⁵⁰ Dhoma e Apelit gjykon se mospërfshirja e kësaj të dhëne në një prej deklaratave të Dëshmitarit 2 nuk përjashton që logjikisht Dhoma Gjyqësore nuk duhet të mbështetet në dëshminë e Dëshmitarit 2.

51. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi gjerësisht transkriptet e bisedës së 10 korrikut 2007 dhe të intervistës me të dyshuarin kur konkludoi se deduksioni i vetëm logjik prej provave ishte se sjellja e Morinës përbënte frikësim dhe ai veproi me synimin e nevojshëm..¹⁵¹ Dhoma e Apelit tashmë ka konkluduar se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në interpretimin e bisedës së 10 korrikut 2007 që tregoi se Morina aludoi për pasojë të rëndë negative nëqoftëse Dëshmitari 2 dëshmonte.¹⁵² Prej Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore del se në nxjerrjen e këtij konkluzioni,

¹⁴⁴ Dosje e Apelit të Morinës, paras 53, 64, 65.

¹⁴⁵ Dosje e Apelit të Morinës, para. 67.

¹⁴⁶ Dosje e Apelit të Morinës, paras 69-72.

¹⁴⁷ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 43-49.

¹⁴⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 48, 49, 55.

¹⁴⁹ *Shih më sipër* Nënkapitulli III.A (Morina, Pikat 1A dhe 2; Haraqija, Pika 4: Pretendim për Gabim në Pranimin e Përgjimeve si Prova); Nënkapitulli III.B (Morina Pika 3; Haraqija Pika 3: Pretendim për Gabim në Pranimin e Intervistës me Të Dyshuarin).

¹⁵⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 55.

¹⁵¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 60 (“Megjithëse sjellja e Bajrush Morinës u shfaq në trajtën e këshillave mirëdashëse dhe ndodhi në një atmosferë miqësore, është e qartë se fjalë e Bajrush Morinës *synonin dhe mund të kuptoheshin vetëm* si thirrje e fortë dhe e qartë ndaj Dëshmitarit 2 [...] që të mos dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*.”) (theksi është shtuar).

¹⁵² *Shih më sipër* Nënkapitulli IV.A (Morina, Pika 1B: Pretendim për Gabime nëpërmjet Keqinterpretimit të Provave të Përgjimeve).

Dhoma Gjyqësore mori plotësisht në konsideratë arsyet alternative të Morinës për takimin me Dëshmitarin 2 si dhe pretendimin e tij për mospasje motivi për të ndihmuar Haradinajn.¹⁵³

52. Veçanërisht Dhoma Gjyqësore theksoi se përmbajtja e artikullit të shkruar pas udhëtimit nuk kishte të bënte aspak me qëllimin e treguar në kërkesën zyrtare për udhëtim apo artikullin e mëparshëm në lidhje me Dëshmitarin 2 që sipas Morinës, ai donte të qartësonte.¹⁵⁴ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte “gjasë që Bajrush Morina të organizonte një udhëtim të ngutshëm personal për konfirmim profesional (të cilin mund ta kishte marrë përmes telefonit) të një artikulli shkruar pesë vjet më parë.”¹⁵⁵ Dhoma e Apelit gjykon se kjo është arsye e mjaftueshme për rrëzimin e shpjegimeve alternative të Morinës në lidhje me udhëtimin për takimin me Dëshmitarin 2. Gjithsesi, fakti se ai shkruajti edhe një artikull për udhëtimin e tij dhe konfirmoi të dhënat e një interviste të mëparshme nuk ndryshon përmbajtjen dhe rëndësinë e pjesëve kryesore të bisedës që rezultuan në verdiktin e shpërfilljes.

53. Gjithashtu argumentet e Morinës lidhur me mungesën e motivit personal për të ndihmuar Haradinajn janë jobindëse. Me të drejtë Dhoma Gjyqësore i akordoi vlerë minimale provuese kësaj dëshmie duke marrë parasysh qartësinë dhe bindshmërinë e transkripteve të bisedës.¹⁵⁶ Sido që të jetë, argumentet e Morinës nuk marrin parasysh se Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai ishte udhëzuar prej eprorit të tij për përcjelljen e kumtit.¹⁵⁷ Në rrethana të tilla mosrëndësia e deklarëtës së tij për mungesën e përkrahjes së Haradinajt prej tij është e dukshme.

54. Rrjedhimisht këto pika të apelit rrëzohen.

V. APELI I ASTRIT HARAQISË

A. Pretendim për Gabime Ligjore dhe Faktuale në Konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me Konfirmimin e Intervistës së të Dyshuarit si Provë (Haraqija Pikat 1 dhe 2)

55. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Morina ndërhyri në dhënien e dëshmisë prej Dëshmitarit 2 në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* “duke iu referuar pushtetit të fuqishëm të të tretëve dhe duke aluduar për pasoja negative” për t’i bërë thirrje që të mos dëshmonte.¹⁵⁸ U konkludua se një sjellje e tillë përbënte frikësim dhe rrjedhimisht shpërfillje të Tribunalit përcaktuar prej Rregullës 77(A)(iv)

¹⁵³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 50-53, 59, 80, 98.

¹⁵⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 80.

¹⁵⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 98.

¹⁵⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 59.

¹⁵⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 49, 53, 100, 102, 110, 115.

¹⁵⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 60.

të Rregullores.¹⁵⁹ Kur lidhi Haraqinë me këtë krim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Haraqija dinte se Dëshmitari 2 ishte dëshmitar në procesin gjyqësor *Haradinaj dhe të tjerë* dhe se ai ushtroi ndikim mbi Morinën kur e udhëzoi të takonte Dëshmitarin 2 me detyrë konkrete ndërhyrjen ndaj dhënies së dëshmisë.¹⁶⁰

56. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore deklaroi: “megjithëse implikimi i Haraqisë vjen kryesisht prej Intervistës së Bajrush Morinës si i Dyshuar dhe Përgjimeve të takimeve midis Bajrush Morinës dhe Dëshmitarit 2, kjo vërtetohet edhe prej tërësisë së provave.”¹⁶¹ Morina nuk dëshmoi dhe rrjedhimisht nuk mund të pyetej prej palës kundërshtare në lidhje me këtë material.¹⁶² Duke iu referuar jurisprudencës së Dhomës së Apelit, Dhoma Gjyqësore theksoi se “dëshmia e një dëshmitari i cili nuk është ballafaquar me pyetje nga pala kundërshtare dhe që ka lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit ka nevojë për “konfirmim të mjaftueshëm” nëqoftëse përdoret si bazë për verdikt fajësie.”¹⁶³ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore shqyrtoi jurisprudencën e Dhomës së Apelit, Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, dhe disa sisteme gjyqësore shtetërore për të përcaktuar çfarë përbën “provë të mjaftueshme” në kontekstin e konfirmimit.¹⁶⁴

Sipas Dhomës Gjyqësore, që një dëshmi të mund të konfirmojë prova të paverifikuara, jo vetëm që duhet të përcjellë mbresën e fortë të vërtetësisë së tyre, me fjalë të tjera të zmadhojë vlerën e tyre provuese, por duhet edhe të sigurohet në mënyrë të pavarur. Në kundërshtim me qasjen teknike ndaj kësaj çështjeje, Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmia konfirmuese mund të përfshijë prova që ndonëse e kanë zanafillën prej të njëjtit burim, dolën në rrethana të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.¹⁶⁵

Kur u mbështet në intervistën me të dyshuarin, Dhoma Gjyqësore shtoi se i kushtoi “kujdesin e duhur faktit nëse informacioni i intervistës konfirmohet prej dëshmive të pavarura, ardhur prej të njëjtit burim, por në mënyrë të pavarur, ose prej burimeve të ndryshme.”¹⁶⁶

57. Haraqija argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor në zbatimin e këtij standardi dhe gjithashtu bëri gabim ligjor dhe faktual kur konkludoi se dëshmia ishte konfirmuese dhe e

¹⁵⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 60, 61.

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 100, 102.

¹⁶¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 86.

¹⁶² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 12, 21.

¹⁶³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 23, që i referohet *Prosecutor v. Jadranko Prlić*, Case No. IT-04-74-AR73.6, Decision on Appeals Against Decision Admitting Transcript of Jadranko Prlić's Questioning into Evidence, 23 November 2007 (“*Prlić Appeal Decision*”), paras 58-59 and *Prosecutor v. Vujadin Popović*, Case No. IT-05-88-AR73.1, Decision on Appeals Against Decision Admitting Material Related to Borovčanin's Questioning, 14 December 2007 (“*Popović Appeal Decision*”), para. 48./*Prokurori k. Jadranko Përliqit*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim në lidhje me Apelet Kundër Vendimit për Pranimin si Provë të Transkriptit të Marrjes në Pyetje të Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007 (“*Vendimi i Apelit Përliq*”), paras 58-59 dhe *Prokurori k. Vujadin Popovićit*, Lënda Nr. IT-05-88-AR73.1, Vendim në lidhje me Apelet Kundër Vendimit për Pranimin si Provë të Materialit në lidhje me Marrjen në Pyetje të Borovqaninit, 14 dhjetor 2007 (“*Vendimi i Apelit Popović*”), para 48.

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 25-40.

¹⁶⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 41.

¹⁶⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 86 (nuk është përfshirë citimi i brendshëm)).

pavarur.¹⁶⁷ Ai kundërshton burimin ligjor përdurur si referencë prej Dhomës Gjyqësore në formulimin e kushtit të saj, duke vënë në pikëpyetje masën e praktikës shtetërore dhe duke argumentuar se analiza e Dhomës Gjyqësore ishte e cekët dhe shumë prej çështjeve të hulumtuara trajtonin aspekte të veçanta, si krimet e sulmeve seksuale.¹⁶⁸ Sipas Haraqisë, verdikti i fajësisë së tij mbështetet kryesisht në dëshmi të tërthorta dhënë prej të bashkakuzuarit Morina, qoftë nëpërmjet bisedave të incizuara, intervistës me të dyshuarin, informacionit të dhënë dëshmitarëve të tjerë, qoftë nëpërmjet dokumenteve të përgatitura prej Morinës.¹⁶⁹ Haraqija argumenton se kushti i Dhomës Gjyqësore “e shkatërron mbrojtjen e duhur që u akordohet të Akuzuarve ndaj deklaratave të paverifikueshme të një të bashkakuzuari”¹⁷⁰ dhe ngatërron “sasinë e provave konfirmuese me cilësinë e këtyre provave”.¹⁷¹

58. Për më tepër, Haraqija kundërshton cilësimin e dëshmisë konfirmuese si të pavarur meqenëse megjithëse erdhi prej Morinës, doli në rrethana të ndryshme.¹⁷² Haraqija argumenton se dëshmia nuk mund të konsiderohet si e pavarur duke qenë se në fund të fundit erdhi prej të njëjtit burim.¹⁷³ Në lidhje me këtë, ai thekson se Dëshmitari 2 dhe Angelina Krasniqi të cilët dëshmuuan në gjyq në lidhje me deklaratat e dhëna nga Morina, pranuan se Morina ishte i vetmi burim i tyre dhe se ata nuk folën asnjëherë drejtpërsëdrejti me Haraqinë.¹⁷⁴ Sa i përket kësaj çështjeje, Haraqija pretendon se “Dhoma Gjyqësore gaboi kur barazoi rregullsinë e përsëritjes me vërtetësinë.”¹⁷⁵

59. Së fundi Haraqija thekson se dëshmia konfirmuese nuk është madje as përputhëse, fakt që duhej ta kishte bërë Dhomën Gjyqësore të hulumtonte alternative të tjera që tregonin pafajësinë e Haraqisë.¹⁷⁶

60. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në të vetmin konkluzion logjik për implikimin e Haraqisë pas një analize të kujdesshme të provave sipas kriterëve përkatëse.¹⁷⁷ Ajo argumenton se Dhoma Gjyqësore pohoi kushtin e saktë për përcaktimin e dëshmive konfirmuese.¹⁷⁸ Prokuroria kundërshton qasjen mekanike dhe teknike të Haraqisë dhe thekson se Dhoma Gjyqësore

¹⁶⁷ Njoftim për Apel i Haraqisë, paras 4-9; Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 7-33; Dosje e Kundërpërgjigjes së Haraqisë, paras 5-11.

¹⁶⁸ Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 20-24.

¹⁶⁹ Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 9, 37-30.

¹⁷⁰ Dosje e Apelit të Haraqisë, para. 9.

¹⁷¹ Dosje e Apelit të Haraqisë, para. 15.

¹⁷² Dosje e Apelit të Haraqisë, para. 25.

¹⁷³ Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 26-31.

¹⁷⁴ Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 28-30.

¹⁷⁵ Dosje e Apelit të Haraqisë, para. 31.

¹⁷⁶ Dosje e Apelit të Haraqisë, paras 32, 33.

¹⁷⁷ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 67-107.

¹⁷⁸ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 70-77.

u përqëndrua në cilësinë e dëshmisë dhe jo në sasi.¹⁷⁹ Rrjedhimisht sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore vlerësoi me të drejtë dëshminë konfirmuese duke theksuar pavarësinë e marrjes së saj dhe përputhshmërinë e lartë me implikimin e Haraqisë.¹⁸⁰ Së fundi, Prokuroria argumenton se shpjegimet alternative të parashtruara prej Haraqisë nuk ishin të logjikshme.¹⁸¹

61. E drejta për t'i bërë pyetje palës kundërshtare nuk është absolute.¹⁸² Dhoma e Apelit ka konkluduar se “parimisht asgjë nuk e ndalon pranimin e dëshmimeve të paverifikuara ose me gjasë jo të verifikueshme prej pyetjeve nga pala kundërshtare.”¹⁸³ Megjithatë Dhoma e Apelit ka pranuar se shkeljet e papranueshme të të drejtave të mbrojtjes [...] ndodhin kur fajësia bazohet tërësisht ose kryesisht në deponimin e dëshmitarit të cilin i akuzuari nuk pati mundësi t’a verifikonte ose ta kishte verifikuar gjatë hetimit ose procesit gjyqësor.”¹⁸⁴ Rrjedhimisht, “fajësia e bazuar mbi këtë dëshmi të këtij lloji pa konfirmim të mjaftueshëm bie ndesh me parimin e drejtësisë.”¹⁸⁵

62. Mjaftueshmëria e konfirmimit të paverifikuar kërkon domosdoshmërisht hulumtim të fakteve konkrete dhe ndryshon rast pas rasti. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit nuk do të përcaktojë kushte ligjore konkrete në lidhje me burimin konfirmues. Për pasojtë Dhoma e Apelit nuk mund të identifikojë gabim ligjor në parimet ligjore të cituara më sipër përdorur prej Dhomës Gjyqësore në vlerësimin e dëshmisë së paverifikuar. Mirëpo çështja kryesore mbetet nëse fajësia bazohet kryesisht mbi dëshmi të paverifikuar. Gjithashtu prej jurisprudences del se jo të tëra dëshmitë e cilësuara s fjalë të dëgjua prej të tjerëve mund të gjykohen si të paverifikuara apo jo të besueshme.¹⁸⁶ Në fakt ligjërisht është i lejueshëm bazimi i fajësisë mbi dëshmi të tërthorta ose rrethanore, por rrethana të tilla kërkojnë kujdes.¹⁸⁷

¹⁷⁹ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 78-83.

¹⁸⁰ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 84-95.

¹⁸¹ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 96-103.

¹⁸² *Prosecutor v. Milan Martić*, Case No. IT-95-11-AR73.2, Decision on Appeal Against the Trial Chamber’s Decision on the Evidence of Witness Milan Babić, 14 September 2006, para. 12. *See also Prlić Appeal Decision*, para. 41; *Popović Appeal Decision*, para. 48. *Prokurori k. Millan Martiqit*, Lënda Nr. IT-95-11-AR73.2, Vendim në lidhje me Apelin Kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Dëshminë e Dëshmitarit Millan Babić, 14 shtator 2006, para.12.

¹⁸³ Vendimi i Apelit Përliq, para. 55. *Shih edhe* Vendimin e Apelit *Popović*, para. 48.

¹⁸⁴ Vendimi i Apelit Përliq, para. 53.

¹⁸⁵ Vendimi i Apelit Përliq, para. 59. *Shih edhe* Vendimin e Apelit *Popović*, para. 48.

¹⁸⁶ *See, e.g., Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez*, Case No. IT-95-14/2-A, Judgement, 17 December 2004 (“*Kordić and Čerkez Appeal Judgement*”), paras 276, 281-284, 291-294; *Prosecutor v. Zlatko Aleksovski*, Case No. IT-95-14/1-AR73, Decision on Prosecutor’s Appeal on Admissibility of Evidence, 16 February 1999, paras 15, 19, 27. *See also The Prosecutor v. Jean-Paul Akayesu*, Case No. ICTR-96-4-A, Judgement, 1 June 2001, para. 287. *Shih edhe Prokurori kundër Dario Kordiqit dhe Mario Čerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004 (“*Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Čerkez*”), paras 276, 281-284, 291-294; *Prokurori k. Zlatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim në lidhje me Apelin e Prokurorit për Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, paras 15, 19, 27. *Shih edhe Prokurori k. Jean-Paul Akayesu*, Lënda Nr. ICTR-96-4-A, Aktgjykim, 1 qershor 2001, para 287.

¹⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Čerkez*, para 294 (që lë në fuqi verdiktin e fajësisë bazuar në dëshmi prej fjalëve të dëgjua dhe dëshmi të tërthorta ku Dhoma Gjyqësore nuk la detaj të aspektit të besueshmërisë pa shqyrtuar dhe të rrethanave ekzistuese). *See also Tharcisse Muvunyi v. The Prosecutor*, *Shih edhe Tharcisse Muvunyi k. Prokurorit*,

63. Dhoma e Apelit kujton se veprimi kyç i frikësimit, u materializua nëpërmjet referimit prej Morinës të “pushtetit të fuqishëm të të tretëve” dhe aludimit për “pasoja të rënda negative” për t’i bërë thirrje Dëshmitarit 2 që të mos dëshmonte.¹⁸⁸ Në lidhje me apelin e Morinës, Dhoma e Apelit tashmë ka konkluduar se ky përfundim ishte konfirmuar mjaftueshëmrisht dhe ishte i logjikshëm¹⁸⁹, dhe nuk vihet në pikëpyetje nga asnjë argument i Haraqisë. Rrjedhimisht pyetja thelbësore është nëse Haraqija ka vërtetuar se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se Haraqija ushtroi ndikim ndaj Morinës dhe e udhëzoi të kryente krimin, mbështetet kryesisht në dëshmi të paverifikuara dhe si pasojë është i padrejtë.

64. Prej vlerësimit të Dhomës Gjyqësore për rolin e Haraqisë në krim, del se ajo shprehimisht shqyrtoi nëse intervista e të dyshuarit u konfirmua mjaftueshëmrisht.¹⁹⁰ Mirëpo siç theksoi Dhoma Gjyqësore kushti i konfirmimit të mjaftueshëm nuk kufizohet vetëm në intervistat si i dyshuar të një të bashkakuzuari që nuk dëshmon, por vlen për të tëra dëshmitë e paverifikuara ku bazohet verdikti i fajësisë.¹⁹¹ Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit gjykon se disa aspekte kyçe të provave të tjera që vijnë prej Morinës të cilat Dhoma Gjyqësore i përdori për konfirmimin e intervistës me të dyshuarin ishin po ashtu të paverifikuara. Megjithëse ekzistojnë prova të besueshme dhe të verifikuara në lidhje me përmbajtjen e bisedave të Morinës me Dëshmitarin 2 dhe Angelina Krasniqin, përmbajtja e bisedave të Morinës me Haraqinë të cilat iu treguan këtyre dëshmitarëve, erdhi prej burimeve të dorës së dytë madje edhe të tretë¹⁹² dhe efektivisht mbetet e paverifikuar. Fakti se Morina mund të ketë diskutuar bisedat e tij me Haraqinë rregullisht dhe në rrethana të ndryshme nuk e ndryshon këtë fakt. Megjithëse sigurisht rregullsia është faktor i vlefshëm, vetëm ajo nuk e bën dëshminë vetvetiu më të besueshme.

65. Prej Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore rezulton se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësinë e duhur rregullsisë së përmendjes së Haraqisë prej Morinës gjatë vijimësisë së ngjarjeve përkatëse.¹⁹³

Case No/Lënda Nr. ICTR-2000-55A-A, Judgement, 29 August 2008, para. 70 (shfuqizim i një verdikti fajësie bazuar në dëshmi prej fjalëve të dëgjuar dhe dëshmi rrethimore ku mungonin hollësitë, para 70)

¹⁸⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 60.

¹⁸⁹ *Shih më sipër* Nënkapitulli IV.A (Morina, Pika 1B: Pretendim për Gabime nëpërmjet Keqinterpretimit të Provave të Përgjimeve); Nënkapitulli IV.B (Morina Pikat 4 - 7: Pretendim për Gabime në Konkluzionin se Morina Kreu Shpërfillje).

¹⁹⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 86, 91.

¹⁹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 41.

¹⁹² Lidhur me këtë Dhoma e Apelit thekson se aludimet e Morinës në lidhje me implikimin e Steven Schook-ut, Zëvendësperfaqësuesi i Posaçëm i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në ndërhyrje, si duket bazohet në një bisedë të Schook-ut me Haraqinë, pa praninë e Morinës. Gjatë intervistës si i dyshuar, Morina pranoi se kishte dyshime në lidhje me implikimin e Schook-ut. *Shih* Proven Materiale 12 të Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), ff. 20-21; Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), f. 23.

¹⁹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 91.

Ndonëse Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi këtë material bashkë me prova të tjera rrethanore,¹⁹⁴ Dhoma e Apelit e cilëson vendimtar. përdorimin prej saj të dëshmisë së paverifikuar të Morinës,

66. Në lidhje me këtë Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi të pamjaftueshme disa mangësive në dëshminë e Morinës. Për shembull ekziston paqartësi e konsiderueshme në përshkrimin prej Morinës të rrethanave të pretendimit për udhëzimin e Haraqisë për ndërhyrje ndaj Dëshmitarit 2. Gjatë intervistës si i dyshuar, Morina aludoi për dy-tri biseda të mundshme që ndodhën në Pejë ose në Prishtinë.¹⁹⁵ Megjithëse Dhoma e Apelit pranon se nuk ishte domosdoshmërisht thelbësore të vërtetoheshin koha dhe vendndodhja e saktë e dhënies së udhëzimit,¹⁹⁶ paqartësia në dëshminë e Morinës bazuar në fjalë të dëgjuara për këtë pikë, duhej të ishte konsideruar problematike. Sa i përket këtij fakti, intervista me të dyshuarin ndodhi vetëm pak muaj pas takimit dhe siç theksoi Dhoma Gjyqësore, ishte arsyeja që Morina ndërmori rrezik profesional qenësor, kur paraqiti kërkesën për udhëtim në shkellje të rregullave të Ministrisë.¹⁹⁷ Intervista e Morinës si i dyshuar gjithashtu zbulon gatishmërinë e tij për shtrembërimin ose ekzagjerimin e fakteve në bisedën e tij me Dëshmitarin 2. Për shembull ai i tha Dëshmitarit 2 se kishte folur me Haraqinë midis bisedave të 10 dhe 11 korrikut 2007, kur më vonë pranoi para hetuesve se kishte folur vetëm me zëdhënësin e Ministrisë.¹⁹⁸ Gjithashtu në bisedën e tij ai aludoi për Steven Schook, mirëpo hetuesve u tha se kishte dyshime nëse faktikisht Haraqija kishte marrë udhëzime prej Schook-ut, apo madje kishte kontaktuar me të.¹⁹⁹

67. Për më tepër Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi të tepruar rrethanave të lejes së udhëtimit. Dhoma Gjyqësore pranoi se do të kishte qenë “pakujdesi e pafalshme” që Morina të kishte implikuar Haraqinë në një mision të ndërmarrë në shkellje të rregullave të Ministrisë.²⁰⁰ Paraqitja e një kërkesë të mëtejshme ku përmendet vetëm Morina, minimizon ndjeshëm çfarëdo deduksioni negativ që mund të nxirret prej kërkesës së parë, duke marrë parasysh veçanërisht se vetëm kërkesa e dytë u miratua zyrtarisht.²⁰¹

¹⁹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 86-99.

¹⁹⁵ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), ff. 18, 22, 30.

¹⁹⁶ Në Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, Dhoma e Apelit konkludoi se një formë përgjegjësie si urdhërimi mund të vërtetohet nëpërmjet provave rrethanore dhe la në fuqi verdiktin e fajësisë së Dhomës Gjyqësore pa prova të drejtpërdrejta për kohën dhe vendin e dhënies së një urdhri konkret. *See Prosecutor v. Stanislav Galic*, Case No. IT-98-29-A, Judgement, 30 November 2006 (“*Galic* Appeal Judgement”), paras 177, 178, 389./*Shih Prokurori k. Stanislav Galiq*, Lënda Nr. IT-98-29-A, Aktgjykim, 30 nëntor 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Galiq*”), paras 177, 178, 389.

¹⁹⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 65, 78, 81, 93, 94, 96.

¹⁹⁸ Prova Materiale 12 e Prokurorisë (biseda e 10 korrikut 2007), ff. 20-21; Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), f. 23.

¹⁹⁹ Prova Materiale 19 e Prokurorisë (intervista e të dyshuarit), f. 23..

²⁰⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 96.

²⁰¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 67, fn. 130.

68. Së fundi, Dhoma Gjyqësore gjithashtu u kushtoi rëndësi të tepruar provave në lidhje me motivet përkatëse të ndryshme të Morinës dhe Haraqisë për kryerjen e krimit. Megjithëse Dhoma Gjyqësore konkludoi logjikisht se rrethanat personale të Morinës si dhe përmbajtja e bisedës me Dëshmitarin 2 sugjeruan se ndaj tij ushtrohej presion,²⁰² jo domosdoshmërisht konkludohet se presioni erdhi prej Haraqisë. Lidhur me këtë Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore po ashtu konkludoi se përmendja prej Morinës e presionit nga të tjerë “synonte të ngjallte keqardhjen e Dëshmitarit 2 për të” dhe rrjedhimisht e çoi një hap më tej ndërhyrjen.²⁰³ Për më tepër megjithëse pjesëmarrja e Haraqisë në komitetin në mbrojtje të Haradinajt në fakt sugjeron një farë motivi për të ndërhyrë ndaj Dëshmitarit 2, në anën tjetër Dhoma Gjyqësore theksoi se ai nuk ishte aleat politik i Haradinajt dhe nuk mori pjesë aktivisht në këtë grup pas mbledhjes së dytë.²⁰⁴ Edhe deklaratat e tij kundër proceseve gjyqësore të kosovarëve logjikisht nuk sugjerojnë se rrjedhimisht ai do të ndërhynte.

69. Për arsyet e mësipërme, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur i kushtoi rëndësi vendimtare dëshmisë së paverifikuar të Morinës për fajësimin e Haraqisë. Rrjedhimisht miratohet pika e dytë e apelit të Haraqisë kundër mjaftueshmërisë së provave konfirmuese dhe shfuqizohet verdikti i fajësisë së Haraqisë për shpërfillje të Tribunalit. Si pasojë Dhoma e Apelit nuk e gjykon të nevojshme të shqyrtojë pikat e tjera të apelit të Prokurorisë kundër dënimit të tij. Në lidhje me fajësinë e Morinës, ligjërisht nuk ka rëndësi nëse Haraqija e udhëzoi faktikisht të ndërhynte ndaj Dëshmitarit 2. Çka është e rëndësishme, është se Morina ishte përçues i interesit të instancave të pushtetit që u pasqyrua prej bisedave të tij.

VI. APELIMET KUNDËR DËNIMIT

70. Pasi e shpalli Morinën fajtor për shpërfillje të Tribunalit, Dhoma Gjyqësore e dënoi me tre muaj burgim.²⁰⁵ Në përcaktimin e dënimit u gjykua se ndërhyrja ndaj ushtrimit të drejtësisë nëpërmjet frikësimit të një dëshmitari “është veçanërisht e rëndë”.²⁰⁶ Dhoma shqyrtoi si faktorët rëndues, po ashtu dhe lehtësues, dhe nuk gjeti faktorë rëndues.²⁰⁷ Si rrethana lehtësuese u konsideruan karakteri i tij i mirë, profesionalizimi, mospasja e precedentëve penalë, presioni me të cilin u përball për kryerjen e shkeljes dhe ndjesa që i ofroi Dëshmitarit 2 për sjelljen e tij.²⁰⁸

²⁰² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 94, 98.

²⁰³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 58.

²⁰⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 82, 85.

²⁰⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 122.

²⁰⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 105.

²⁰⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 107.

²⁰⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 109-111.

71. Dhoma e Apelit kujton se Dhomat Gjyqësore janë mvëshur me kompetencë të gjerë në përcaktimin e dënimit të përshtatshëm.²⁰⁹ Përgjithësisht Dhoma e Apelit e rishikon dënimin vetëm nëqoftëse apeluesi provon se Dhoma Gjyqësore ka bërë “gabim të dukshëm” në ushtrimin e kompetencës ose nuk ka zbatuar ligjin përkatës.²¹⁰

A. Apeli i Morinës Kundër Dënimi të Tij (Pikat 8 dhe 9)

72. Morina argumenton se Dhoma Gjyqësore dha “dënim qartësisht të skajshëm”, bazuar në gabimet e saj të dukshme në lidhje me mosmarrjen parasysh të rrethanave lehtësuese përkatëse dhe peshës së krimit.²¹¹ Konkretisht, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk e gjykoi si rrethanë lehtësuese faktin se takimi midis Morinës dhe Dëshmitarit 2 u zhvillua “në një atmosferë miqësore”, me këmbënguljen e Dëshmitarit 2 dhe miratuar prej policisë vendëse dhe se Dëshmitari 2 nuk u ndje i kërcënuar apo i frikësuar në asnjë moment.²¹² Gjithashtu Morina pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi pa ofruar shpjegim se frikësimi i dëshmitarit është më i rëndë se çfarëdo metodë tjetër e ndërhyrjes ndaj ushtrimit të drejtësisë.²¹³

73. Prokuroria përgjigjet se Morina nuk ka identifikuar gabim të dukshëm në vlerësimin e rrethanave lehtësuese ose të peshës së krimit prej Dhomës Gjyqësore.²¹⁴

74. Dhoma e Apelit thekson se Morina nuk përmendi në argumentet e tij në lidhje me rrethanat lehtësuese, atmosferën “miqësore” të bisedës së 10 korrikut 2007.²¹⁵ Përgjithësisht, Dhoma Gjyqësore nuk është e detyruar të gjejë informacion që avokati nuk e gjykoi të përshtatshëm për t’ia paraqitur në kohën e përshtatshme.²¹⁶ Për më tepër në kundërshtim me argumentet e Morinës, në kontaktet e ndryshme me të, Dëshmitari 2 nuk ishte krejt i çliruar prej frikës. Pasi theksoi se Dëshmitari 2 “nuk u ndje i frikësuar ose nën presion për arsye se takimi [i 10 korrikut 2007] me Bajrushin ishte miqësor”,²¹⁷ Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi këtë çështje së bashku me reagimin e dëshmitarit ndaj thirrjes së parë telefonike prej Morinës për organizimin e takimit, që rezultoi në

²⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 40; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 352; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 38; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 53.

²¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Dragan Jokić*, para. 40; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 353; Aktgjykimi i Apelit *Jović*, para. 38; Aktgjykimi i Apelit *Marjačić dhe Rebić*, para. 53.

²¹¹ Njoftim për Apel i Morinës, paras 16, 17; Dosje e Apelit të Morinës, paras 74-83.

²¹² Dosje e Apelit të Morinës, paras 75-79.

²¹³ Dosje e Apelit të Morinës, paras 80-83; Dosje e Apelit të Morinës, para. 12.

²¹⁴ Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë, paras 50-66.

²¹⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 108; T. 348.

²¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 359. See also *The Prosecutor v. Mikaeli Muhimana*, Case No. ICTR-95-1B-A, Judgement, 21 May 2007, para. 231. *Shih edhe Prokurori k. Mikaeli Muhimana*, Lënda Nr. . ICTR-95-1B-A, Aktgjykim, 21 maj 2007, para 231.

²¹⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 57, citohet Dëshmitari 2, T. 140.

ndjenjën e “frikës së menjëhershme” dhe të “rrezikut”.²¹⁸ Pavarësisht prej kësaj Dhoma Gjyqësore e mori parasysh pa rezerva disponimin miqësor të Morinës ndaj Dëshmitarit 2 gjatë takimit të 10 korrikut 2007 kur pranoi karakterin e tij të mirë dhe ndjesën e tij ndaj dëshmitarit.²¹⁹ Si pasojë, Morina nuk ka identifikuar asnjë gabim të dukshëm të Dhomës Gjyqësore në vlerësimin e rrethanave lehtësuese prej saj.

75. Dhoma e Apelit gjithashtu nuk gjen gabim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se frikësimi i një dëshmitari është veçanërisht i rëndë.²²⁰ Në kundërshtim me argumentin e Morinës, Dhoma Gjyqësore shprehimisht pohoi se “në vlerësimin e peshës së veprës penale, Dhoma Gjyqësori mori parasysh rëndësinë e mundësimit të ushtrimit të duhur të drejtësisë nëpërmjet mbrojtjes së dëshmitarëve prej çfarëdo ndërhyrjeje që synon ndryshimin e dëshmisë së tyre apo madje edhe tërheqje prej dhënies së dëshmisë.”²²¹ Kjo deklaratë ishte në vijim të pranimin prej saj të problemeve që çështja *Haradinaj dhe të tjerë* “hasi në marrjen e dëshmive prej dëshmitarëve në një atmosferë të konsideruar e pasigurtë prej shumë dëshmitarëve.”²²² Për më tepër, pesha e krimit duket qartë prej mbështetjes së konsiderueshme të Tribunalit Ndërkombëtar në provat e dëshmive të dhëna dhe detyrimit të tij në Statut dhe Rregullore për marrjen e masave mbrojtëse për dëshmitarë dhe garantimin e ndershmërisë së procesit.²²³

76. Rrjedhimisht këto pika të apelit hidhen poshtë.

B. Apeli i Prokurorisë

77. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore shpërdoroi kompetencën e saj kur përcaktoi një dënim qartësisht të pamjaftueshëm për Morinën pasi e kishte shpallur fajtor për një krim veçanërisht të rëndë të shpërfilljes së Tribunalit, me anë të frikësimit të dëshmitarit.²²⁴ Ajo thekson se megjithëse Dhoma Gjyqësore theksoi se dy faktorët më të rëndësishëm që duhen marrë parasysh në përcaktimin e dënimit janë pesha e krimit dhe nevoja për parandalimin e shkeljeve në të

²¹⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 57, citohet Prova Materiale 8 e Prokurorisë, paras 13, 14.

²¹⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 109, 111.

²²⁰ *Shih Prokurori k. Beqë Beqajt*, Lënda Nr. IT-03-66-T-R77, Aktgjykim në lidhje me Akuzat për Shpërfillje, 27 maj 2005 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Beqaj*”), para. 60 (“Veprimet që synojnë të pengojnë një dëshmitar prej dhënies së dëshmisë apo të ndikojnë ndaj dëshmisë që do të jape, përbëjnë ndërhyrje të rëndë ndaj ushtrimit të drejtësisë.”).

²²¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 107.

²²² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 106.

²²³ *Shih* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Beqaj*, para. 60.

²²⁴ Njoftim për Apel i Prokurorisë, ff. 1, 2; Dosje e Apelit të Prokurorisë, paras 2-17; Dosje e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paras 10, 11. Njoftim për Apel i Prokurorisë. Njoftimi për Apel i Prokurorisë ka dy pika të apelit, një në lidhje me Haraqinë dhe një tjetër për Morinën. Mirëpo Dosja e Apelit të Prokurorisë i argumenton të dy pikat së bashku. Në kontekstin e përfundimeve të Dhomës së Apelit për apelin e Haraqisë, do të shqyrtohen vetëm argumentet e Prokurorisë kundër Morinës.

ardhmen, ajo i shpërfilli këta faktorë në përcaktimin e dënimit.²²⁵ Sipas Prokurorisë, thjesht pohimi i këtij standardi nuk përmbushi detyrimin e Dhomës Gjyqësore në dhënien e dënimit.²²⁶

78. Në lidhje me peshën e krimit, Prokuroria thekson se në dhjetor 1998, Rregullorja u ndryshua duke e ndarë shpërfilljen në formën e kërcënimit, frikësimit ose ndryshe ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve prej formave të tjera të shpërfilljes dhe duke e shtuar dënimin në shtatë vjet si pasqyrim të peshës së krimeve.²²⁷

79. Më tej Prokuroria argumenton se parandalimi kërkon dënim më të gjatë meqenëse një individ mund të gjykojë se një burgim prej tre ose pesë muajsh për ndërhyrje, është rrezik i pranueshëm për të ndihmua dikë që rrezikohet me dënim të përjetshëm.²²⁸ Gjithashtu përmenden veprimet ndërhyrëse në çështjet *Haradinaj dhe të tjerë* dhe *Limaj dhe të tjerë* që nxjerrin në pah nevojën për efektin e duhur parandalues.²²⁹ Rrjedhimisht Prokuroria kërkon që dënimet e Haraqisë dhe Morinës të bëhen përkatësisht dy vjet dhe një vit.²³⁰

80. Sipas Morinës, Prokuroria nuk ka provuar se ndërhyrja ndaj dëshmitarëve është forma më e rëndë e shpërfilljes.²³¹ Ai kundërshton referimin prej Prokurorisë të ndryshimit të vitit 1998 në Rregullore për ndarjen e strukturave të dënimit, duke theksuar se kjo praktikë ndryshoi sërish pas tri vjetësh dhe u rikthyen dënimet e njëtrajtshme.²³² Më tej ai thekson nevojën e individualizimit të dënimeve.²³³ Gjithashtu argumentohet se Dhoma Gjyqësore mori plotësisht parasysh nevojën e parandalimit kur dha dënimin dhe ky është vetëm një ndër faktorët që duhen marrë parasysh, dhe jo më i rëndësishmi siç sugjeron Prokuroria.²³⁴ Së fundi ai thekson se duke marrë parasysh rrethanat e tij individuale, dënimi i tij është i rëndë dhe është një prej dënimeve më të rënda për shpërfillje, dhënë prej Tribunalit Ndërkombëtar.²³⁵

81. Ashtu siç pranoi edhe Prokuroria, Dhoma Gjyqësore theksoi me të drejtë rëndësinë e peshës së krimit dhe nevojën për parandalimin e veprimeve të ngjashme gjatë përcaktimit të dënimit të

²²⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 6; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paras 4, 17.

²²⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 16.

²²⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 9, citohet Raporti i Gjashtë Vjetor i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare Kryer në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, UN. Doc. A/54/187, S/1999/846, f. 30, para. 114; Dosje e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 5.

²²⁸ Dosje e Apelit të Prokurorisë, para 14; Kundërpërgjigje e Prokurorisë, para. 6.

²²⁹ Dosje e Apelit të Prokurorisë, para. 15.

²³⁰ Njoftim për Apel i Prokurorisë, pp. 1, 2. Dosje e Apelit të Prokurorisë, para. 17.

²³¹ Dosje e Përgjigjes së Morinës, paras 8-13.

²³² Dosje e Përgjigjes së Morinës, para. 10.

²³³ Dosje e Përgjigjes së Morinës, paras 12, 13.

²³⁴ Dosje e Përgjigjes së Morinës, paras 14-16.

²³⁵ Dosje e Përgjigjes së Morinës, para. 17.

përshtatshëm.²³⁶ Lidhur me këtë, kur vlerësoi peshën e krimit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh argumentin e Prokurorisë se frikësimi i Dëshmitarit 2 ishte “veçanërisht flagrant” duke marrë parasysh se ndodhi në kontekstin e një procesi gjyqësor ku shumë dëshmitarë kishin frikë të dëshmonin.²³⁷ Si rezultat, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi peshën e krimit kur dënoi Morinën dhe Haraqinë. Po ashtu, megjithëse parandalimi dhe shpagimi merren parasysh në dhënien e dënimit, këtyre faktorëve nuk u duhet kushtuar rëndësi e tepruar në kuadrin e vlerësimit të përgjithshëm të dënimeve ndaj personave të shpallur fajtorë prej Tribunalit Ndërkombëtar.²³⁸

82. Së fundi argumenti i Prokurorisë nuk merr parasysh se Dhomat Gjyqësore kanë detyrim parësor të individualizojnë dënimin në përshtatje me rrethanat e të akuzuarit dhe peshën e krimit.²³⁹ Lidhur me këtë siç u theksua më sipër, Dhoma Gjyqësore gjeti disa rrethana lehtësuese në dobi të Morinës dhe nuk identifikoi rrethana rënduese për Morinën. Prokuroria nuk i kundërshton këto konkluzione dhe as nuk tregon pse një Dhoma Gjyqësore që logjikisht merr parasysh si duhet rrethanat e shumta lehtësuese, nuk duhej të kishte dhënë dënimet e Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, pavarësisht prej peshës së krimit.

83. Rrjedhimisht apelimi i Prokurorisë kundër dënimit hidhet poshtë.

VII. VENDIM

84. Për arsyet e mësipërme, Dhoma e Apelit,

BAZUAR në Nenin 25 të Statutit dhe Rregullat 77, 77bis, 116bis, 117, dhe 118 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimet e palëve;

KUJTON palët që të dorëzojnë variantet publike të dosjeve të tyre apeluese, në rast se nuk e kanë bërë këtë;

HEDH POSHTË kërkesën e Haraqisë për argument gojor;

MIRATON Pikën 2 të apelit të Haraqisë dhe **SHFUQIZON** verdiktin e tij të fajësisë;

HEDH POSHTË pikat e apeleve të Morinës dhe Prokurorisë;

²³⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 103, 112, 114.

²³⁷ *Shih* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paras 106, 107. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konstatoi se ky problem ishte pranuar në *Prokurori v. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008, para. 6.

²³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 442.

²³⁹ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 442.

DUKE MARRË SHËNIM se Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina kanë qenë në lirim të përkohshëm të kushtëzuar pas kryerjes së dënimeve dhënë prej Dhomës Gjyqësore;

URDHËRON përfundimin e kushteve të lirit të përkohshëm të tyre;

DUKE MARRË SHËNIM se Bajrush Morina ka të drejtën t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim;

E DEKLARON plotësisht të kryer dënimin me burgim të Bajrush Morinës.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht, teksti anë anglisht ka përparësi.

Më 23 korrik 2009, Në Hagë, Holandë.

Gjykatës Liu Daqun
Kryetar

Gjykatës Iain Bonomy

Gjykatës Mehmet Güney

Gjykatës Fausto Pocar

Gjykatëse Andréia Vaz

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]